

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5953
E premte, 13 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Për nëntë muaj 279 raste
për korrupsion u dërguan
në prokurori | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA PEZULLUAR ZBATIMIN E
LIGJIT PËR PAGA NË SEKTORIN PUBLIK | FAQE 3

Kushtetuesja pezullon Ligjin për paga, arsimiti dhe shëndetësia hyjnë në grevë

Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka pezulluar përkohësisht Ligjin për paga sipas kërkesës së Avokatit të Popullit. Ligji për paga do të jetë i pezulluar deri më 30 mars të këtij viti. Punonjës në sektorë të ndryshëm publikë tashmë kanë filluar t'i shprehin pakënaqësitë e tyre. Disa punonjës në sektorë të ndryshëm publikë

kërkojnë që Ligji për paga të fillojë të zbatohet dhe pagat e dhjetorit t'i marrin me rritje, kurse disa të tjerë kërkojnë që ky ligj të mos zbatohet. Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) dhe Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) sot do ta fillojnë grevën



LV-ja dhe LDK-ja vazhdojnë përpjekjet për arritjen e marrëveshjes | FAQE 4-5

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, nuk janë takuar të enjten, ndonëse një ditë më parë ishin pajtuar t'i shtojnë takimet për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Lideri i LV-së ka pranuar se ende nuk ka diçka konkrete në këtë drejtim, por që janë duke bërë përpjekje për arritjen e marrëveshjes. "Ne jemi duke u përgatitur që të qeverisim mirë. Sa i përket çështjes së bisedimeve me LDK-në nuk mund të kem lajme të reja pa pasur rezultate konkrete. Këtë jua kam thënë edhe më herët, po e përsëris sërish", ka thënë Kurti

Kosova hap ambasadën në Norvegji, ambasadori Emra dorëzon letrat kredenciale



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

**SHOIPËRIA NË
KRYE TË OSBE-SË:
SHKËLQIMI QË
DUAM FILLON NGA
BRENDA** F. 8



Prof. Lisen BASHKURTI

AKTUALE



**POLICIA PËR DY MUAJ
KONFISKOI 49 VETURA** F. 6

**ARIANIT SHEHU MERR NGA
JORDANIA ÇMIMIN 'NDERI I
KOMBIT' PËR AVANCIMIN E
DEMOKRACISË** F. 6

EKONOMI



**PRIVATIZIMI NUK KURSEN
TOKAT BUJQËSORE** F. 9

**KOSOVA NË MALAJZI
PREZANTON PËRVOJAT PËR
ZBATIMIN E REFORMAVE TË
FINANCEVE PUBLIKE** F. 9

SPORT

**DISTRIA S'NJEH KUNDËRSHTAR
NË KINË, RRËMBEN TË ARTËN**

F. 20

Macroni udhëheq konferencën e donatorëve për Shqipërinë



BRUKSEL, 12 DHJETOR - Konferenca e donatorëve ndërkombëtarë në ndihmë të Shqipërisë do të mbahet më 19 ose 20 janar. Deklarata erdhi nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron, gjatë një mbledhje të liderëve të Këshillit Evropian në Bruksel. Ai bëri thirrje

për të kontribuar në rindërtimin e zonave të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit, ndërsa idenë e konferencës së donatorëve e dha fillimisht në samitin e NATO-s në Londër. "Do të flasim dhe për atë që ka ndodhur në Shqipëri. Dua të jap një mesazh solidariteti për

popullin shqiptar. Do të organizojmë një konferencë ndërkombëtare donatorësh për të qenë sa më pranë Shqipërisë në këto momente të vështira, ku dhjetëra persona kanë humbur jetën dhe mijëra të tjerë banesat", tha Macroni.

Mundësitë dhe sfidat e Shqipërisë si kryesuese e OSBE-së

Në një diskutim në Komisionin e Helsinkit u fol për përparësitë që do t'i ketë Shqipëria, por u tha se mangësitë që vazhdon t'i ketë vendi në procesin e demokracisë brenda vendit, mund ta kufizojnë efektivitetin e saj për zgjidhjen e problemeve të ngjashme në zonën e OSBE-së



TIRANË, 12 DHJETOR - Shqipëria e fillon kryesimin e radhës së OSBE-së për vitin 2020, ndërkohë që rajoni ku vepron organizata përballlet me sfida të konsiderueshme sigurie dhe të demokracisë. Në një diskutim në Komisionin e Helsinkit, anëtarë të delegacionit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së, folën për përparësitë që do t'i ndjekë Tirana në vitin kur mban kryesinë. Por mangësitë që vazhdon t'i ketë Shqipëria në procesin e demokracisë brenda vendit, mund ta kufizojnë efektivitetin e saj për zgjidhjen e problemeve të ngjashme në zonën e OSBE-së, ka njoftuar voa.

Këshilltari politik i Komisionit të Helsinkit, Bob Hand, tha se kryesia e radhës organizatës më të madhe rajonale në botë, është një nder por edhe një sfidë, në kushtet e agresionit rus kundër Ukrainës dhe kërcën-

imeve ndaj vendeve të tjera fqinjë, disa konflikteve rajonale, rezistencës ndaj reformave demokratike në disa vende dhe zbrapsjes serioze të demokracisë në vende të tjera. "Ne në Komisionin e Helsinkit besojmë se përfaqësuesi më i lartë i OSBE-së, duhet të mishërojë frymën e 10 parimeve të Helsinkit dhe zbatimit të të gjitha angazhimeve të OSBE-së. Kjo nuk do të thotë që duhet të ketë një rekord të përkryer, dhe madje as një nga më të mirët mes 57 vendeve. Do të thotë që të jetë duke ecur qartë në drejtimin e duhur dhe të jetë qartësisht i përkushtuar ndaj asaj rruge. Kryesia kërkon kompetencë dhe aftësi, por edhe besueshmëri", tha Hand. Ditmir Bushati, kryetar i delegacionit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së dhe ish-ministër i Jashtëm, tha se pas anëtarësimit në NATO (në vitin 2009), kjo

është arritja më e madhe e politikës së jashtme të Shqipërisë. "Ne në Shqipëri, veçanërisht ky delegacion, jemi shumë të kënaqur me këtë sukses dhe ne synojmë ta transformojmë këtë, në një projekt uniteti kombëtar", tha ai.

Bushati tha se proceset demokratike që pas vitit '90 kur Shqipëria ishte konsumatore e sigurisë, ishin të vështira dhe shpesh të dhimbshme, por shtoi se Shqipëria është tani një faktor stabiliteti.

Rudina Hajdari, anëtare e opozitës në delegacionin e Shqipërisë, the se ky është një hap madhor për vendin. "Mendoj se është e rëndësishme që kur vihemi përpara sfidave që janë goxha të rëndësishme për interesin e Shqipërisë, siç

është kryesimi i OSBE-së, duhet të kemi vullnetin që të shfaqemi bashkë me njëri tjetrin krah për krah, për të treguar se Shqipëria është në gjendje që të ketë një unitet kombëtar kur vjen fjala për interesin e Shqipërisë", tha ajo për "Zërin e Amerikës".

"Tani ne ndodhemi në një udhëkryq goxha të vështirë, sepse kemi probleme, sfida brenda vendit tonë, por edhe në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi", shtoi ajo.

Por ndasitë dhe krizat politike në Shqipëri, ishin një temë e pashmangshme duke pasur parasysh që disa nga ato sfida me të cilat përballlet OSBE-ja dhe do t'i duhet Shqipërisë të merret si kryesuese e radhës, ajo i ka ende të pazgjidhura plotësisht vetë, si sistemi zgjedhor,

lufta kundër korrupsionit dhe shteti ligjor, si edhe demokratizimi.

Një shembull është debati i fundit për paketën antishpifje, që OSBE-ja ka sugjeruar të rishikohet por që qeveria deri tani duket se nuk ka synim ta bëjë.

Hand tha se çështje si kjo vënë në pikëpyetje autoritetin moral të Shqipërisë kur trajton çështje të lirisë së medias në vende të tjera. "Shqetësimi im kryesor është se, është problematike për Shqipërinë e Shqipëria t'i ketë këto ligje, por edhe do të jetë e vështirë që Shqipëria që të ngrejë zërin për lirinë e shprehjes në ato vende të OSBE-së që kanë më shumë kufizime se Shqipëria në këtë drejtim", i tha Hand "Zërit të Amerikës". "Shqipëria duhet të përparojë në këto fusha, nëse do që si kryesuese e OSBE-së, t'u bëjë thirrje vendeve të tjera të marrin hapa në një drejtim pozitiv", tha ai.

Bushati parashtrori përparësitë e Shqipërisë si kryesuese e radhës, përfshirë mbështetjen e misionit të OSBE-së në Ukrainë, operacionet në terren me personelin e plotë dhe aktual, promovimin e lirive themelore, misionet e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe nxitjen e diplomacisë parlamentare në shërbim të dialogut.

Shqipëri - ShBA, marrëdhënie të shkëlqyera në fushën e mbrojtjes

TIRANË, 12 DHJETOR - Në kuadër të Saminit të Mbrojtjes së nismës ShBA - Karta e Adriatikut, që u zhvillua të mërkurën në Tiranë, ku njëzëri u theksua mbështetja për anëtarësimin e gjithë vendeve të Evropës Juglindore në strukturat euro-atlantike, ministrja shqiptare e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka zhvilluar takime të posaçme me homologë të saj. Ministrja Xhaçka ka zhvilluar një takim me ndihmës asistenten e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Laura Cooper, ku u diskutua për marrëdhënien e

shkëlqyer mes dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes dhe mundësinë e angazhimit të Shqipërisë në misionin e NATO-s në Irak.

Ndërsa gjatë takimit të zhvilluar me ministrin e Mbrojtjes të Kosovës Rustem Berisha, Xhaçka e ka falënderuar për ndihmën e menjëhershme dhe të paçmuar të FSK-së pas tërmetit të 26 nëntorit.

Me homologen nga Bosnjë e dhe Hercegovina, Marina Pendesh, siç tha ministrja, ramë dakord për intensifikimin e

bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë.

Ministrat e mbrojtjes së Kartës së Adriatikut A-5, në një deklaratë të përbashkët të mërkurën shprehën angazhimin për të ndërtuar kapacitete të përbashkëta ndaj fatkeqësive të natyrës. Në deklaratën përfundimtare të takimit në Tiranë, ministrat e vendeve të Kartës së Adriatikut nxitur edhe nga pasojat që shkaktoi tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri u shprehën se qëndrojnë pranë popullit shqiptar në këto çaste të vështira.



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka pezulluar zbatimin e Ligjit për paga në sektorin publik

Kushtetuesja pezullon Ligjin për paga, arsimi dhe shëndetësia hyjnë në grevë



Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka pezulluar përkohësisht Ligjin për paga sipas kërkesës së Avokatit të Popullit. Ligji për paga do të jetë i pezulluar deri më 30 mars të këtij viti. Punonjës në sektorë të ndryshëm publikë tashmë kanë filluar t'i shprehin pakënaqësitë e tyre. Disa punonjës në sektorë të ndryshëm publikë kërkojnë që Ligji për paga të fillojë të zbatohet dhe pagat e dhjetorit t'i marrin me rritje, kurse disa të tjerë kërkojnë që ky ligj të mos zbatohet. Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) dhe Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës (FSShK) sot do ta fillojnë grevën

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur që të pezullohet zbatimi i Ligjit për paga në sektorin publik. Në një komunikatë për media të Gjykatës Kushtetuese, thuhet të zbatohet "masa e përkohshme në kohëzgjatje deri më 30 mars 2020, nga data e nxjerrjes së këtij vendimi" dhe të "pezullohet menjëherë zbatimi i këtij ligji në kohëzgjatje të njëjtë". Ligjin për paga, më 6 dhjetor të këtij viti në Gjykatën Kushtetuese e ka dërguar institucioni i Avokatit të Popullit për, siç thuhet, "vlerësimin e përputhshmërisë" së këtij ligji me Kushtetutën. Ligji për paga është miratuar në muajin shkurt të këtij viti, kurse në fil-

lim të këtij muaji ka hyrë në fuqi.

Ky ligj rregullon rritjen e pagave për 70 për qind të punëtorëve në sektorin publik, kurse 30 për qind mbeten jashtë. Por, punonjës në sektorë të ndryshëm publikë tashmë kanë filluar t'i shprehin pakënaqësitë e tyre. Disa kërkojnë që Ligji për paga të fillojë të zbatohet dhe pagat e dhjetorit t'i marrin me rritje. Kurse disa të tjerë kërkojnë që ky ligj të mos zbatohet për shkak se e cilësojnë diskriminues. Sindikatat që kërkojnë zbatimin e ligjit tashmë kanë paralajmëruar greva. Federata Sindikale e Shëndetësisë ka paralajmëruar se më 13 dhjetor 2019, duke filluar nga ora 7:00 deri në orën 15:00, të mbahet grevë e përgjithshme brenda institucioneve shëndetësore.

Edhe Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) për sot (e premte) ka paralajmëruar grevë dyorëshe, duke filluar nga çerdhet deri tek universitetet.

SBASHK-u ka njoftuar se punëtorët e arsimit në Kosovë do ta shprehin kërkesën që pagat e dhjetorit t'i marrin në bazë të Ligjit për paga. "Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, pas diskutimeve të shumta, e duke përcjellë zërin e të punësuarve në arsim, ka autorizuar kryetarin e SBASHK-ut dhe kryesinë që në koordinim me Federatën e Sindikatës së Shëndetësisë dhe atë të Policisë të nis bashkërisht veprimet sindikale. Duke u bazuar në këtë dhe në koordinim të plotë me këto dy federata, të premtën, më 13. 12. 2019, mbahet grevë dyorëshe paralaj-

jmëruese në çerdhe, në universitete dhe në të dy ndërrimet e mësimin në të gjitha shkollat e Kosovës, me kërkesën drejtuar institucioneve që të punësuarit në arsim dhe gjithë të tjerët pagën e dhjetorit ta marrin bazuar në Ligjin e pagave", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.

Sipas këtij njoftimi, greva dyorëshe në çerdhe fillon nga ora 6:30 deri në orën 8:30. "Greva në universitete fillon në orën 8:00 deri në orën 10:00. Greva në shkollat e Kosovës mbahet në dy orët e para në të dy ndërrimet", është thënë në këtë njoftim.

SBASHK-u ka paralajmëruar institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për paga, se greva dyorëshe në arsim është alarmi i fundit dhe kushdo që punon për t'i zhgënjyer punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të policisë së Kosovës, duhet ta dijë se do të përballet me reagime shumë radikale sindikale.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ta pezulluar Ligjin për pagat, Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka reaguar përmes një njoftimi për media. FSShK-ja ka bërë thirrje që punëtorët shëndetësorë të vazhdojnë për-

gatitjet për grevën e sotme (e premte). "I lusim të gjithë punëtorët shëndetësorë që t'i vazhdojnë përgatitjet për grevën e nesërme, njëherësh apelojmë të të gjithë që ta ruajnë qetësinë dhe njoftojmë opinionin e gjerë se Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës do të fillojë takime intensive me punëtorë që ta nxjerrim opinionin e duhur në lidhje me veprimet e ardhshme sindikale. Njëherësh, njoftojmë opinionin e gjerë që të gjitha pasojat në rast të reagimit më radikal të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës do t'i bartin politikëbërsit që, siç duket, kanë dorë", është thënë në njoftimin e FSShK-së.

Edhe nënkryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Shaban Tasholli, ka thënë se kjo sindikatë është e pakënaqur me këtë vendim të kësaj gjykate. "Jemi të pakënaqur. Për dy vjet kemi punuar në këtë ligj së bashku me qeverinë, menaxhmentin e policisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ne nuk e kemi pritur mirë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ne i kemi bërë thirrje gjykatës që mos ta marrë vendimin, por ta shikoj ligjin", ka thënë Tasholli.

Edhe një ditë pas takimit që kanë pasur Albin Kurti dhe Isa Mustafa, kanë vazhduar polemikat mes zyrtarëve të Lëvizjes Vetëv

LV-ja dhe LDK-ja vazhdojnë përpl



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, nuk janë takuar të enjten, ndonëse një ditë më parë ishin pajtuar t'i shtojnë takimet për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Lideri i LV-së ka pranuar se ende nuk ka diçka konkrete në këtë drejtim, por që janë duke bërë përpjekje për arritjen e marrëveshjes. "Ne jemi duke u përgatitur që të qeverisim mirë. Sa i përket çështjes së bisedimeve me LDK-në nuk mund të kem lajme të reja pa pasur rezultate konkrete. Këtë jua kam thënë edhe më herët, po e përsëris sërish", ka thënë Kurti

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 DHJETOR - As të enjten nuk ka pasur ndonjë përpjekje të re të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për ta arritur marrëveshjen për bashkëqeverisje. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i LDK-së, Isa Mustafa, nuk janë takuar, ndonëse një ditë më parë ishin pajtuar që t'i shtojnë takimet për arritjen e marrëveshjes për

bashkëqeverisje. Pretenduesi kryesor për kryeministër, Albin Kurti, e ka pranuar se ende nuk ka diçka konkrete mes këtyre dy subjekteve politike. Ai ka deklaruar se LV-ja dhe LDK-ja po përgatiten të qeverisin mirë. "Ne jemi duke u përgatitur që të qeverisim mirë. Sa i përket çështjes së bisedimeve me LDK-në nuk mund të kem lajme të reja pa pasur rezultate konkrete. Këtë jua kam thënë edhe më herët, po e përsëris sërish. Sot nuk ka takim, por do të ketë takime dhe

komunikime të vazhdueshme dhe më të dendura derisa ta arrijmë marrëveshjen që dëshirojmë", ka thënë Kurti, duke shtuar se kur të ketë diçka konkrete do të njoftohet opinioni publik. "Kur t'i kemi rezultatet konkrete jap lajme të reja. Por, rezultate konkrete nuk ka. Presidenti i Kosovës e ka shtyrë në maksimum datën se kur do të mbahet mbledhja konstituive për legjislaturën e shtatë sepse data e fundit ka qenë 26 dhjetori. Na ka dhënë më shumë kohë se që na është

Fehmi Shaqiri nderohet me çmimin 'Mjeshtër i Madh'

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se Fehmi Shaqirit ia ka ndarë çmimin "Mjeshtër i Madh" për kontributin e tij në ruajtjen dhe promovimin e vler-

ave kombëtare shqiptare. "Me çmimin 'Mjeshtër i Merituar' sot e dekorova Fehmi Shaqirin, i cili me dekada të tëra ka kontribuar për ruajtjen dhe promovimin e vlerave tona kombëtare. Ai i ka dhënë shumë kulturës sonë në

Shqipëri, në Kosovë dhe kudo në diasporën shqiptare. Familja Shaqiri në vazhdimësi ishte e angazhuar për ruajtjen e identitetit tonë kombëtar", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



endosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

ekjet për arritjen e marrëveshjes



tike. Domethënë, vota për LV-në është votë e idealit për shtetin dhe vizionin e jetës me dinjitet në Kosovë. Pesha e votës është e njëjtë, por pastërtia e marrëdhënies ndërmjet votës dhe subjektit politik është po aq e rëndësishme", ka shkruar Abazi.

Sipas tij, sjelljet e tilla të zyrtarëve të LDK-së dërgojnë ujë në mullirin e "Prontos". "Deklarimi me gjuhë arrogante dhe mungesa e modestisë është karakteristikë e atyre që e kanë dëmtuar rëndë interesin e qytetarit dhe të vendit. Në atë proces LV-ja nuk ka participuar asnjëherë. Arroganca e zyrtarit të LDK-së në media nuk paraqet as pikëpamjet e votuesit të LDK-së që ka votuar për ndryshimin e madh që duhet të ndodhë, rrjedhimisht kujdes nga pozicionet që zbehin besimin, dërgojnë ujë në mullirin e 'Prontos' dhe ia rikujtojnë elektoratit formulat të cilat pas shenjës së barazimit kanë interesin individual dhe jo atë shtetëror", ka vlerësuar Abazi, duke shtuar se qeveria Kurti nuk ka alternativë.

Ndërsa deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hatim Baxhaku, ka reaguar ndaj deklaratës së Abazit, duke thënë se ai është arrogant dhe jo zyrtarët e LDK-së. "Haki Abazi, i cili shquhet për arrogancë, paska folur për arrogancën e LDK-së! Çfarë injorance!", ka shkruar Baxhaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Analistët: Posti i presidenti të mos përfshihet në marrëveshje

Njohësit e rrethanave politike e kanë bërë fajtorë LDK-në për mosarritjen e marrëveshjes me LV-në. Sipas tyre, partia e Isa Musafës duhet të heqë dorë nga posti i presidentit. Analisti politik Imer Mushkolaj ka deklaruar për "Epokën e re" se LDK-ja po kërkon me ngulm postin e presidentit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për disa arsye. "Sigurisht, po qe se do të donte të punonte sa e si duhet në këtë ministri, e ka pasur shansin të tregohet më herët. Për të tjerat mund të spekulohet. Por nëse LDK-ja insiston që t'i marrë edhe postin e presidentit, edhe ministrinë, atëherë kapaciteti për ta luftuar krimin dhe korrupsionin, nëpërmjet përmirësimeve sistematike, do të ishte jashtëzakonisht i kufizuar dhe ndërmarrja e veprimeve do të bëhej e vështirë, për të mos thënë e pamundur", ka thënë Mushkolaj. Sipas tij, insistimi i

LDK-së për këto dy poste ka të bëjë me përpjekjen për të bllokuar iniciativat që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit. "Kjo nuk është e pamundur kur kihet parasysh kompetencat kushtetuese që i ka posti i presidentit. Dhe ato nuk janë pak. Ndër të tjera, me propozimin e Këshillit Gjyqësor ai emëron dhe shkarkon kryetarin e Gjykatës Supreme, ai emëron dhe shkarkon gjyqtarët, emëron dhe shkarkon kryeprokurorin e shtetit dhe prokurorët me propozimin e Këshillit Prokurorial, si dhe emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese me propozimin e Kuvendit", ka vlerësuar Mushkolaj.

Edhe analisti tjetër politik, Belul Beqaj, ka thënë për "Epokën e re" se LDK-ja nuk duhet të insistojë në këto dy poste. "LDK-ja s'po kupton se sovranit ka filluar ta ndaj shapin prej sheqerit. Zgjedhësit deri në këto zgjedhje janë frikësuar nga ndryshimi, ndërsa tashti janë të sigurt se mosndryshimi është më i rrezikshëm se ndryshimi! Është kohë e duhur që LDK-ja të transformohet në drejtim të vetëdijes politike së sovranit", është shprehur Beqaj. Sa i përket MPB-së, ai ka deklaruar se LDK-ja nuk duhet ta udhëheqë këtë ministri. "Kompromisi është bërë me faktin se ministri, zëvendësimistër e ka përfaqësuesin e

partisë tjetër. Logjikisht 'shtetin e kapur' nuk mund të 'shkapin' ata që kanë qenë, në periudha të ndryshme, pjesë të 'shtetit të kapur'. Prandaj, logjikisht, në këto dikastere nuk duhet të jenë ata që kanë qenë pjesë të politikave të tilla", ka thënë Beqaj.

Zyrtarët e LDK-së dhe të LV-së kanë pranuar publikisht se negociatat mes këtyre dy partive kanë ngecur në këto dy pika. LDK-ja insiston që në marrëveshje duhet të përfshihet edhe posti i presidentit, të cilën e kundërshton Lëvizja Vetëvendosje. Po ashtu, LDK-ja ka kërkuar ta ketë Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilën e ka kërkuar edhe LV-ja.

Kosova hap ambasadën në Norvegji, ambasadori Emra dorëzon letrat kredenciale

OSLO, 12 DHJETOR (ER) - Kosova ka hapur Ambasadën në Oslo të Norvegjisë. Ambasadori i parë i Kosovës në Oslo, Uliks Emra, të enjten i ka dorëzuar letrat kredenciale të lartmadhëria e tij, mbreti i Norvegjisë, Harald V, duke u akredituar si ambasador fuqiptotë i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë. Ambasadori Emra, duke përcjellë përshëndetjet e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe popullit të Kosovës, ka falënderuar lartmadhërinë e tij, mbretin Harald V, për kontributin e pakursyer dhe gjithëpërfshirës që Mbretëria e Norvegjisë i ka ofruar vendit tonë gjatë gjithë këtyre viteve. "Mbretëria e Norvegjisë është një ndër

vendet e para e cila e ka njohur Republikën e Kosovës dhe për këtë populli i Kosovës do të jetë mirënjohës përjetësisht. Relacionet ndërmjet dy vendeve janë të shkëlqyeshme, ndërsa synimi është që ato të thelohen edhe më tej në fusha specifike", ka thënë Emra. Ndërsa Mbreti Harald, pasi ka shprehur përshëndetjet e tij të përzemërta për presidentin Thaçi, ka theksuar se janë shumë të lumtur për vendimin e Republikës së Kosovës për hapje të Ambasadës në Oslo. Ai ka thënë se ky është një moment i veçantë në relacionet ndërmjet dy vendeve. "Mbretëria e Norvegjisë do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në të gjitha fushat dhe për këtë mund të jeni shumë të sigurt",

ka thënë ai.

Uliks Emra ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik si dhe masterin në shkencat penale në Universitetin e Prishtinës, ndërsa specializimin në diplomaci në Universitetin e Zagrebit. Ai është diplomat i karrierës, i cili ka kryer funksione të rëndësishme në institucionet shtetërore dhe në hierarkinë e lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ai ka qenë zëvendës drejtor i përgjithshëm, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm, zëvendësambasador në Kroaci, i ngarkuar me punë në Ambasadën e Kosovës në Kroaci dhe sekretar në Institutin për Hulumentimin e Krimeve të Luftës.



dashur", ka thënë Kurti në një konferencë për medie.

Edhe një ditë pas takimit të tretë Kurti - Mustafa, zyrtarët e këtyre dy subjekteve politike kanë vazhduar përplasjet në distancë. Deputeti i zgjedhur i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, ka deklaruar se arroganca e disa zyrtarëve të LDK-së në media nuk paraqet pikëpamjet e votuesit të LDK-së që ka votuar për ndryshim. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se zyrtarët e LDK-së duhet të kenë kujdes nga pozicionet që zbehin besimin. "Duhet trajtuar me respekt e me kujdes përpjekja për të përcaktuar një standard të ri të arritjes së marrëveshjeve për bashkëqeverisje, sidomos kur kjo përpjekje dhe gatishmëri vjen nga LV-ja si fituese e parë e votës së pavarur, të pakushtëzuar, të pafavorizuar, votës nga diaspora që nuk është e varur nga përfitimet e mundshme poli-

Arianit Shehu merr çmimin "Nderi i Kombit" nga Jordania për avancimin e demokracisë

Prishtinë, 12 dhjetor (ER) - Drejtori i lartë i Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) për Lindje të Mesme, me bazë në Aman të Jordanisë, Arianit Shehu, është shpërblyer nga kryeministri i Jordanisë, Omar Razzaz.

Në një ceremoni të veçantë, kryeministri jordanez në emër të Mbretit Abdullah II të Jordanisë ia ndau çmimin e nderit Arianit Shehut për kon-

tributin dhënë në avancimin e demokracisë në Lindjen e Mesme.

Drejtori i NDI-së, Arianit Shehu, është shprehur i lumtur për çmimin e dhënë nga Mbretëria e Jordanisë, duke ia dedikuar këtë popullit dhe shtetit të Kosovës. "Ky është një nder i madh për mua si person, por edhe për vendin tim. Këtë çmim ia dedikoj popullit tim për të cilat vështrësi e sfida ka

kaluar në ndërtimin e shtetit dhe demokracisë. Ky është edhe një shembull se shqiptarët nga Kosova janë pjesë e përpjekjeve të rëndësishme ndërkombëtare", është shprehur Shehu.

Drejtori Arianit Shehu ka marrë pjesë si anëtar i Institutit Demokratik Kombëtar në misionet në Ukrainë, Gjeorgji, Egjipt, së fundmi është me bazë në Aman të Jordanisë.



Lumezi pret në takim ambasadoren e Francës, flasin për sundimin e ligjit

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka pritur të enjten në takim njoftues ambasadoren e Francës në Kosovë, Marie-Christine Butel. Kryeprokurori Lumezi e ka informuar ambasadoren Butel për punën dhe të arriturat e Prokurorit të Shtetit në luftimin e veprave të ndryshme penale që ndërlidhen me korrupsionin, krimin e organizuar, terrorizmin, ngrirjen dhe sekuestrimin e pasurisë së fituar me anë të veprave penale si dhe luftimin e të gjitha formave të tjera të krimit në Republikën e Kosovës.

Po gjatë këtij takimi kryeprokurori i Shtetit ka folur edhe për objektivat e institucionit që udhëheq, me qëllim të rritjes së efikasitetit në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Në anën tjetër, ambasadorja Butel ka vlerësuar punën e Prokurorit të Shtetit, duke ofruar mbështetjen e vendit që përfaqëson për ta ndihmuar sistemin prokurorial të Kosovës. Të dy bashkëbiseduesit kanë çmuar bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe Ambasadës së Francës në Kosovë si dhe kanë theksuar nevojën e thellimit dhe avancimit të bashkëpunimit ndër-institucional edhe në të ardhmen, më theks të veçantë në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në mes të institucioneve të drejtësisë kosovare dhe atyre franceze, në luftimin e të gjitha veprave kriminale që cenojnë rendin dhe sigurinë e të dy vendeve.

Në fund të takimit, kryeprokurori



i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka falënderuar ambasadoren Marie-Christine Butel për vizitën dhe

interesimin e treguar për sistemin prokurorial, duke e vlerësuar mbështetjen dhe përkrahjen e

vazhdueshme të Francës dhënë institucioneve të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Shoqata e Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës mban kuvendin e parë vjetor



PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Shoqata e Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, e mbështetur nga OSBE-ja, ka mbajtur kuvendin e parë vjetor, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësueset të EULEX-it, të ICITAP-it dhe partnerit të tjerë, të cilët mbështesin ShKK-në. Në kuvend është diskutuar për punën dhe sfidat me të cilat përballen gratë që punojnë në institucione korrektuese.

Përmes këtyre diskutimeve kjo shoqatë synon të kultivojë një mjedis që inkurajon zyrtarët e institucioneve korrektuese për barazi gjinore, etnike në vendin e

punës dhe shoqëri, si një aspekt i forcimit të sundimit të ligjit dhe trajtimit të barabartë.

Me këtë rast, kryetarja e Shoqatës së Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Zyrafete Imeraj, tha se kjo shoqatë është e angazhuar për ta fuqizuar rolin e grave në institucionet korrektuese të vendit. "Përmes kësaj shoqate ne synojmë avancimin e statusit të grave në profesion", ka thënë Imeraj.

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, e ka përgëzuar kryetaren Imeraj për punën e bërë deri më tani, njëherësh i ka inku-

rajuar të gjitha gratë që në të ardhmen të konkurrojnë më shumë në pozita udhëheqëse brenda shërbimit pasi, sipas tij, pa dyshim gruaja do ta zë vend të merituar dhe të barabartë brenda sistemit korrektues.

Në fund, kryetarja e Shoqatës së Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Zyrafete Imeraj, i ka falënderuar donatorët dhe të gjitha gratë pjesëmarrëse në këtë kuvend. Kuvendi ka vazhduar me punëtorinë nga e cila kanë dalë rekomandimet për hartimin e Strategjisë zhvillimore të shoqatës.

Policia për dy muaj konfiskoi 49 vetura

PEJË, 12 DHJETOR (ER) - Stacionet dhe Njësitet e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë gjatë muajit tetor dhe nëntor të këtij viti, gjatë kontrolleve rutine dhe planeve të ndryshme, kanë hasur në dyzet e nëntë (49) automjete, pronarët e të cilave kanë kryer veprën 'shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore'.

Drejtorja Rajonale e Policisë në Pejë, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit dhe me Doganën e Kosovës, automjetet e konfiskuara i kanë dërguar në terminalin doganorë në të cilat pronarët e tyre janë detyruar ta bëjnë pagesën për zhdoganimin e këtyre automjeteve.

Ndaj pronarëve të automjeteve janë iniciuar procedura ligjore

dhe të njëjtat janë dërguar në Prokurorinë e Shtetit për procedurë të mëtejshme ligjore.

Policia e Kosovës apelon te të gjithë qytetarët që kanë në posedim mjete motorike e që nuk i kanë kryer obligimet doganore, para se të dalin në rrugë t'i kryejnë këto obligime, përndryshe Policia e Kosovës ndaj këtyre ngasësve të automjeteve do të ketë zero tolerancë.



Për nëntë muaj 279 raste për korrupsion u dërguan në prokurori



Vetëm gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2019 janë dërguar 279 raste në prokurori që kanë lidhje me korrupsion. Shkalla e zgjidhjes së tyre është 94 për qind. Kështu u bë me dije të enjten në tryezën e diskutimit "Sinjalizuesit në luftën kundër korrupsionit në prokurim publik"

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 DHJETOR - KDI, D+ dhe INPO, si pjesë e koalicionit të organizatave joqeveritare (OJQ), për Javën Kundër Korrupsionit 2019, të enjten, kanë mbajtur tryezën e diskutimit "Sinjalizuesit në luftën kundër korrupsionit në prokurim publik". Në këtë tryezë u prezantuan të gjeturat lidhur me shkeljet e përsëritura në prokurim publik, roli i bizneseve në luftën kundër korrupsionit në këtë sektor, roli i sinjalizuesve në ekspozimin e korrupsionit në prokurim publik si dhe roli dhe

vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit i cili vendos se ku shkojnë milionat në prokurim publik.

Vedat Poterqoi nga INPO ka prezantuar shkeljet në prokurim publik në komunat e Kosovës. Ai ka thënë se asnjë zyrtar i prokurimit publik nuk është dënuar me formë të aktgjyqimit të prerë në vitin 2018.

Diana Metushi Krasniqi nga KDI-ja ka prezantuar disa raste konkrete ku sinjalizuesit nga sektori biznesit kanë ndihmuar në ekspozimin e korrupsionit në prokurim publik. Ajo ka potencuar nevojën e rritjes së

integritetit në biznes kundër kësaj dukurie me qëllim të përfitimeve për të gjithë qytetarët.

Ndërsa Agon Hysaj nga D+ ngriti shqetësimet lidhur me vendimet e OShP-së. Ai ka theksuar se ky organ është përgjegjës për shpenzimet e rreth 300 milionë eurove përmes prokurimit publik dhe se me vendimet e tyre janë identifikuar shkelje ligjore apo amnistim i veprave penale nga bizneset e papërgjegjshme. Më tutje, Osman Vishaj nga KRPP-ja ka folur për të mirat që ka sjellë implementimi i E-Prokurimit në Kosovë dhe për nevojën e rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional.

Sa iu përket shkeljeve të ligjit të prokurimit nga zyrtarët publikë, ai ka theksuar se KRPP-ja do ta fillojë të zbatojë masa ndëshkuese, përfshirë marrjen e licencës.

Zejnullah Gashi nga Këshilli Prokurorial i Kosovës ka thënë se vetëm gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2019 janë dërguar 279 raste në prokurori që kanë lidhje me korrupsion dhe shkalla e zgjidhjes së këtyre rasteve është 94 për qind. Nga Drejtoria për Krime Ekonomike pranë Policisë së Kosovës, Bashkim Spahiu ka thënë se policia ka hetuar tri raste që kanë lidhje me korrupsionin në prokurim publik, nga të cilat kanë rezultuar tri kallëzime penale për nëntë zyrtarë publikë, në mesin e tyre edhe një anëtar i OShP-së. Nga Agjencia Anti-Korrupsion, Blerim Kelmendi prezantoi përgatitjet institucionale për mbrojt-

jen e sinjalizuesve dhe theksoi nevojën urgjente për hartimin e rregullores për sinjalizim të brendshëm.

Agim Sheqiri nga OShP-ja ka thënë se ka probleme nga ana e institucioneve publike, me theks të veçantë në kriteret tenderuese, ku shumë institucione vendosin kriteret për ta eliminuar konkurrencën.

Panelistët dhe pjesëmarrësit u pajtuan se mungon një bashkëpunim ndërinstytucional, se ende nuk ka luftim të mirëfilltë të korrupsionit dhe mbështetje të sinjalizuesve dhe se llogaridhënia, respektivisht dënimet për shkelje në prokurim publik, duhet të jenë prioriteti kryesor i të gjitha institucioneve të drejtësisë pasi përmes prokurimit shpenzohet rreth 30 për qind e parasë publike.

Haradinaj priti në takim lamtumirës ambasadorin e Italisë

PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim lamtumirës ambasadorin e Italisë, Piero Cristoforo Sardi, të cilin e ka falënderuar për kontributin e dhënë gjatë misionit të tij në Kosovë, për fuqizimin e raporteve diplomatike ndërmjet dy shteteve.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, e njoftoi ambasadorin Sardi për zhvillimet e përgjithshme në vend, duke theksuar përkushtimin e institucioneve të Kosovës për avancimin e raporteve bilaterale, në fusha të interesit reciprok. Duke vlerësuar rolin e Italisë në

periudhat e shtetndërtimit, kryeministri në detyrë, Haradinaj,

falënderoi ambasadorin Sardi për të gjithë përkrahjen që Italia ka dhënë në të gjitha etapat në Kosovë, duke theksuar se kjo përkrahje duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen në proceset jetike për vendin, liberalizimin e vizave, por edhe për anëtarësimin e Kosovës në BE dhe në NATO. "Jemi mirënjohës për gjithë angazhimin tuaj dhe të Italisë për përkrahje të proceseve të rëndësishme politike për vendin tonë, duke synuar që ky bashkëpunim të avancojë edhe në fushën e zhvillimit ekonomik", tha kryeministri në detyrë Haradinaj, duke theksuar



kontributin e veçantë që Italia ka dhënë dhe vazhdon të japë në fushën e sigurisë, në kuadër të

forcave paqeruajtëse të KFOR-it. Ambasadori në largim, Piero Cristoforo Sardi, falënderoi

kryeministrin në detyrë, Haradinaj, për pritjen dhe për bashkëpunimin e deritanishëm.

Privatizimi nuk kursen tokat bujqësore

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Sipërfaqet e tokave bujqësore në pronë publike në Kosovë nuk janë kursyer gjatë procesit të privatizimit. Rreth 30 mijë hektarë tokë bujqësore, asete të ish-ndërmarrjeve shoqërore, janë shitur gjatë procesit të privatizimit, kurse rreth 26 mijë hektarë sipërfaqe të tokës kanë mbetur pa u privatizuar, thonë zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Agjencia Kosovare e Privatizimit nëpërmjet valëve të privatizimit në vazhdimësi ka shpallur në shitje sipërfaqe të ndryshme të tokës bujqësore. Në një raport të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të publikuar në muajin nëntor të këtij viti, thuhet se janë privatizuar 663 toka bujqësore dhe toka të kategorive të tjera, pa specifikuar sipërfaqen. Nga ky numër thuhet

se 595 janë tokë bujqësore, kurse 68 toka të kategorive të tjera. E gjithë kjo sipërfaqe, sipas raportit të AKP-së, është shitur për rreth 164 milionë euro.

Nga mbjellja dhe kultivimi i kulturave bujqësore, këto toka tashmë janë kthyer në hapësira biznesi apo në lagje banimi, thonë përfaqësues të bujqve në Kosovë. Ata shprehen të shqetësuar me shitjen e tokës. Sipas tyre, tokave të privatizuara bujqësore tashmë u është ndërruar destinimi dhe në këtë mënyrë po zvogëlohet sipërfaqja mesatare e tokës bujqësore për kokë banori.

Kryetari i Federatës Sindikale të Bujqve, Tahir Tahiri, në një bisedë për Radion Evropa e Lirë thotë se pikërisht privatizimi i tokës bujqësore ka bërë që të zvogëlohen edhe hapësirat e mbjella me drithëra,

pasi në këto sipërfaqe janë ndërtuar objekte të ndryshme të cilat nuk krijojnë ndonjë leverdi as në aspektin ekonomik e as bujqësor. Ai tregon se Federata Sindikale e Bujqve ka kërkuar nga organet kompetente që ta ndalojnë privatizimin e tokave bujqësore. "Tokat janë shitur me një çmim shumë të lirë, madje mund të them se parcelat e shitura janë falur. Pronarët që i kanë blerë këto parcela që 15 vjet nuk i punojnë fare sepse kanë biznese të tjera më të leverdishme. Disa parcela janë keqpërdorur duke u shitur për biznese të llojeve të ndryshme", thotë ai.

Tahiri thotë, po ashtu, se tokat që kanë qenë rreth autostradave janë shitur për biznese të llojeve të ndryshme duke ndërruar destinimin. "Do të thotë, është bërë një

keqpërdorim shumë i madh", thekson ai. Sipas një raporti të mëhershëm të Ministrisë së Bujqësisë, është thënë se për një ari tokë çmimi mesatar ka qenë 34 euro, kurse për një hektar 3 400 euro.

Privatizimin e tokave e quan vendim të gabuar edhe Mejd Bektashi, profesor në Universitetin e Prishtinës. Ai thotë se sipërfaqet e tokës duhet të sigurohen për investitorë potencialë, kryesisht ata të huaj. "Do të ishte mirë që qeveria e ardhshme ta ndalojë me ligj privatizimin e tokave bujqësore me qëllim që të njëjtat të ruhen për qëllime ekonomike, respektivisht për tërheqjen e investitorëve të huaj për të investuar në Kosovë", tha Bektashi.

Ndërkaq Tahir Tahiri thotë se Federata Sindikale e Bujqve po

pret krijimin e qeverisë së re në mënyrë që ta kërkojë edhe zyrtarisht ndalimin e procesit të privatizimit për tokat bujqësore. "Dëmet e shkaktuara nga ky privatizim vështirë se mund të riparohen me dekada. Po presim që të formohet qeveria e re dhe ne do kërkojmë nga qeveria që të merren hapat konkretë dhe të sanohen dëmet e shkaktuara me rastin e privatizimit të tokave", thotë Tahiri.

Qeveria e Kosovës në fund të vitit 2017 kishte marrë vendim për ta pezulluar përkohësisht, për një afat njëvjeçar, privatizimin e tokave në pronësi shoqërore, në mënyrë që të verifikohen nevojat që kanë institucionet shtetërore për prona, me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe investimeve.



Bujar Tërstena (RFE/RL)

Kosova në Malajzi prezanton përvojat për zbatimin e reformave të financave publike



PRISHTINË, 12 DHJETOR (ER) - Në Malajzi po mbahet konferenca "Zhvillimi i kapaciteteve të kontabilitetit në ekonominë në zhvillim" në të cilën po marrin pjesë Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, zëvendësauditor i Përgjithshëm Ilir Salihu, drejtori i përgjithshëm i Thesarit, Ahmet Ismaili dhe drejtoresha ekzekutive e Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), Ardiana Bunjaku. Përfaqësuesit nga Kosova para përfaqësuesve të shumë shteteve pjesëmarrëse

në konferencë, në panelin me temë "Roli i Thesarit dhe Auditorit të Përgjithshëm në adresimin e sfidave të reformës në Menaxhimin e Financave Publike (MFP)" prezantuan përvojat e shtetit tonë për dizajnimin dhe zbatimin e reformave të financave publike. Panelistët nga Kosova kanë prezantuar pikëpamjet e tyre lidhur rëndësinë e reformës në menaxhimin e financave publike, mënyrën e koordinimit me palët e tjera dhe kanë nënvizuar aktivitetet e Zyrës Kombëtare të Auditimit,

Thesarit të Kosovës dhe kontributin e partnerëve nga organizatat ndërkombëtare dhe komuniteti i donatorëve.

Kjo konferencë është organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Bankën Botërore dhe ka për qëllim shkëmbimin e përvojave në fushën e financave publike midis vendeve me ekonomi të brishta dhe vendeve të zhvilluara.

Zbulohet busti i Destan Bajraktarit

SUHAREKË, 12 DHJETOR (ER) - Në Komunën e Suharekës është bërë zbulimi i bustit të mësuesit Destan Bajraktari. Me këtë rast, kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se Bajraktari do të nderohet gjithmonë nga gjenerata që jetuan me të dhe gjeneratat që mësuan nga ai. "Librat e shumtë të shkruara nga ai, tregojnë mes të tjerash vlerat e një intelektualit i cili e nderoi atdheun e tij. Për virtytet e vazhdueshme atdhetare, arsimore dhe folklorike, regjimi totalitar serb në Kosovë e kishte shpallur person të rrezikshëm dhe pas shumë përgjimesh sekrete edhe e bur-

gosin më 1959, duke e dënuar me 5 vjet e gjashtë muaj burgim", ka thënë Muharremaj, duke theksuar se suksesi i Destan Bajraktarit në zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteti i gjithëmbarshtëm i tij me popullatën shqiptare do të vlerësohet në histori. "Megjithatë, ai nuk u ndal dhe vepra e tij kujtohet edhe pas vdekjes së tij me respekt të veçantë. Ai sot po vjen në vepër artistike, në shkollën që e mban emrin e tij. Ne do ta nderojmë dhe kujtojmë gjithmonë për kontributin dhe përkushtimin e tij për kombin. E përjetshme qoftë lavdia e tij!", është shprehur Muharremaj.



Më 14 dhe 15 dhjetor mbahet Panairi i Prodhimeve Vendore në Prizren

PRIZREN, 12 DHJETOR (ER) - Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Prizrenit ka bërë me dije se këtë fundjavë organizon Panairin e prodhimeve vendore, i cili ka qenë i paraparë të organizohet më 28. 11.

2019 dhe ishte anuluar për shkak të tërmetit në Shqipëri. Panairi do të mbahet të shtunën dhe të dielën (14-15 dhjetor) në Sheshin e Dëshmorëve, ndërsa hapja do të bëhet të shtunën në orën 12:00.



Gjilani shpërndan fidanë të arrës për 22 fermerë

GJILAN, 12 DHJETOR (ER) - Drejtoria e Bujqësisë në Gjilan ka shpërndarë fidanë të arrës për fermerët, të cilët do t'i mbjellin 15 hektarë me këtë kulturë. Gjatë shpërndarjes së këtij subvencioni, nënkryetari i Komunës, Arbër Ismajli, i ka uruar fermerët, ndërkaq ka shprehur zotimin se komuna edhe në vitin e ardhshëm do ta vazhdojë mbështetjen edhe më të madhe ndaj tyre, me të gjitha kapacitetet.

Drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka shfaqur zotimin se do t'u qëndrojnë prapa fermerëve për zbatimin e plotë të këtij projekti. "Komuna e Gjilanit i ka dhënë mundësi të mëdha sektorit të pemëtarisë dhe fokusin e mbajtur kryesisht te kulturat industriale. Kemi pasur kërkesa të vazhdueshme nga fermerët për mbështetjen në kulturën e arrës. Kemi vlerësuar se komuna jonë ka kushte



të mira klimatike dhe tokësore për kultivimin e arrës, mbi të gjitha është kulturë e perspektivës, me treg të sigurt", ka thënë ai. I pari i bujqësisë në Gjilan ka numëruar rezultatet e punës për këtë vit, duke theksuar se 2019-ta ka qenë vit jashtëzakonisht i suksesshëm për këtë sektor. "Kemi pasur partneritet me Komisionin Evropian, shkollën e agrobiznesit

'Arbëria' e donatorë të tjerë në favor të blegtorëve. Kemi subvencionuar plotësisht mbjelljet pranverore dhe vjeshtore dhe kemi bërë përpjekje për t'i përzgjedhur projektet kapitale investuese për t'ua lehtësuar punën bujqve. E falënderoj kryetarin Haziri dhe nënkryetarin Ismajli për mbështetjen e madhe që ia kanë dhënë këtij sektori", ka përfunduar Ramadani.

Pas dhjetë vjetësh fshati Zasellë fillon të furnizohet me ujë të pijshëm



MITROVICË, 12 DHJETOR (ER) - Si rezultat i mobilizimit të qytetarëve nën asistencën e KDI-së, në fshatin Zasellë, me afërsisht 300 banorë, është finalizuar projekti për furnizimin e fshatit me ujë të pijshëm. Në vitet 2008-2009 në fshatin Zasellë kishte filluar projekti për furnizim me ujë të pijshëm. Në atë kohë punimet për ujë të pijshëm janë zhvilluar me ritëm të ulët, pastaj janë pezulluar. Ndërkaq banorët e këtij fshati për dhjetë vjet me radhë kanë parashtruar kërkesa për vazhdimin dhe përfundimin e pro-

jektit në fjalë. Krahas kërkesave të vazhdueshme të kryesisë së fshatit Zasellë, kjo çështje është diskutuar edhe në dy takime të mbajtura në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve komunalë të organizuara nga KDI-ja, njëra në tetor të vitit 2018 dhe tjetra në muajin gusht të vitit 2019. Drejtoria e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në takimin e mbajtur në tetor të vitit 2018, pati premtuar se do ta trajtojë me prioritet çështjen e furnizimit me ujë të pijes dhe se gjatë vitit 2019 do ta finalizojë këtë

projekt. Përgjatë kësaj kohe, KDI-ja, duke kontaktuar me zyrtarët përgjegjës komunalë, është interesuar vazhdimisht për kohën e rifillimit të projektit për furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Zasellë. Si rezultat i takimeve dhe mobilizimit të qytetarëve në pranverën e vitit 2019 institucionet përgjegjëse bën hapin e parë dhe rifilluan punimet e lëna në gjysmë për më shumë se dhjetë vjet më parë, ndërsa në muajin dhjetor është finalizuar projekti për furnizimin me ujë të pijshëm.

Komuna e Drenasit më 24 dhjetor organizon tubim me qytetarët për fundvit

DRENAS, 12 DHJETOR (ER) - Më 24 dhjetor (e martë), në orën 11:00, Komuna e Drenasit do të organizojë takim me qytetarët për fundvit. Sipas një njoftimi të

kësaj komune, përfaqësuesit e Komunës së Drenasit do t'i informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës gjatë këtij viti, për të arriturat, vështirësitë

dhe synimet si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe t'i japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunalë lidhur

me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmuajin e parë dhe çështje të tjera në interes të qytetarëve të komunës.



Rusia dëbon dy diplomatë gjermanë

MOSKË, 12 DHJETOR - Rusia ka njoftuar se do të dëbojë dy diplomatë gjermanë pasi Berlioni ka vepruar njëjtë me dy diplomatë rusë javën e kaluar. Ministria e Jashtme në Moskë ka thënë më 12 dhjetor se ka thirrur për intervistim ambasadorin gjerman, Geza Andreas von Geyr dhe e ka informuar se dy diplomatët gjermanë kanë shtatë ditë për t'u larguar nga Rusia. "Duke vepruar sipas parimit të reciprocitetit dhe artikullit 9 të Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike të

vitit 1961, ana ruse ka vendosur t'i shpallë dy punëtorët e Ambasadës gjermane persona të padëshiruar në Rusi", është thënë në deklaratë. Javën e kaluar, Gjermania ka dëbuar dy diplomatë rusë, pasi Zyra e Prokurorit Federal ka thënë më 4 dhjetor se "ka të dhëna të mjaftueshme" që ose agjencitë e Qeverisë ruse apo agjencitë rajonale çeçene kanë urdhëruar vrasjen e një gjeorgjiani 40-vjeçar në Berlin, me origjinë çeçene. Ministria e Jashtme gjermane e ka cilësuar veprimin e Moskës

"të pa-arsyetueshëm". Zelimkhan Khangoshvili është qëlluar dy herë në kokë për vrasje më 23 gusht. Khangoshvili ka luftuar më parë me separatistët në rajonin rus të Çeçenisë dhe më pas ka bërë kërkesë për refugjatë në Gjeorgji. Disa vjet më vonë ai është bartur në Gjermani me familjen e tij duke kërkuar edhe azil. Lidhur më këtë vrasje është identifikuar një 49-vjeçar me pasaportë ruse. I dyshuari është thënë të ketë qenë i përfshirë edhe në vrasjen e një biznesmeni rus më 2013.



Kush do të jetë kryeministri i ri britanik?

Zgjedhjet e së enjtes në Britani do të përcaktojnë se kush do të jetë kryeministër i ardhshëm, Boris Johnson apo Jeremy Corbyn. Nëse njëra parti fiton më shumë se gjysmën e vendeve në Parlament, ajo do të formojë qeverinë dhe lideri i saj do të bëhet kryeministër

LONDËR, 12 DHJETOR - Britanikë votuan të enjten për zgjedhjen e qeverisë së re - për herë të dytë qëkur Mbretëria e Bashkuar votoi për Brexit-in, apo daljen nga Bashkimi Evropian. Gjatë fushatës, Brexit-i pashmangshëm ka qenë lart në agjendë dhe kryeministri aktual, Boris Johnson, është zotuar se do ta përfundojë. Procesi është zhargitur me vite për shkak të mospajtimeve të thella politike mbi kushtet e divorcit. Ende nuk dihet saktë se kur do të ndodhë, edhe pse 31 janari është caktuar si datë e mundshme, ka njoftuar rfe. Udhëheqësi i Partisë opozitare Laburiste, Jeremy Corbyn, nuk pajtohet me qëndrimin e Johnsonit se Brexitit duhet të kryhet me ose pa marrëveshje. Dhe ai, në qendër të fushatës së tij ka pasur kujdesin shëndetësor. Corbyn e ka portretizuar veten si mbrojtës të Shërbimit Kombëtar të Shëndetit dhe është zotuar se do t'i rrisë shpenzimet për të. Me këto vizione krejt të

ndryshme për të ardhmen, të paraqitura nga liderët e dy partive kryesore politike dhe disa parti më të vogla - që po ashtu luajnë role potencialisht vendimtare - këto janë ato që duhen ditur për zgjedhjet në Britani. Nëse njëra parti fiton më shumë se gjysmën e vendeve në Parlament, ajo do të formojë qeverinë dhe lideri i saj do të bëhet kryeministër. Për dekada, qeveritë e tilla të shumicës ishin rezultati më i zakonshëm. Por, kjo ka ndodhur vetëm një herë në tri palë zgjedhjet e kaluara. Dy rastet e tjera kanë prodhuar "parlamente të varura", me asnjë parti mjaftueshëm të fuqishme sa për të qeverisur e vetme. Në të tilla raste, partia më e madhe zakonisht ka mundësinë e parë për të mbledhur shumicën parlamentare dhe për të formuar qeverinë. Nëse njëra parti fiton më shumë se gjysmën e vendeve në Parlament, ajo do të formojë qeverinë dhe lideri i saj do të



bëhet kryeministër. Kur kryeministrja Theresa May i ka thirrur zgjedhjet e përgjithshme më 2017, sondazhet e opinionit i kanë dhënë Partisë së saj Konservatore një përparësi prej së paku 20% kundrejt opozitës laburiste. May, me anë të zgjedhjeve, ka bërë përpjekje të zgjerojë shumicën parlamentare të partisë së saj - të fituar në vitin 2015 - me shpresën se do të siguronte marrëveshjen për Brexit. Por, gjërat nuk kanë shkuar sipas planeve. May ka pësuar humbje poshtëruese. Partia e saj Konservatore ka humbur shu-

micën dhe është detyruar të mbështetet në dhjetë votat e Partisë së Bashkuar Demokratike, për të ruajtur kontrollin me një qeveri të pakicës. Partisë Laburiste, ndërkaq, mbështetja i është rritur ndjeshëm, me 32 ulëse. Sondazhet kombëtare tregojnë se Partia Konservatore ka përparësi të qartë. Kështu ka treguar edhe një anketë e kryer nga kompania e respektuar, YouGov, megjithëse analistët paralajmërojnë se të gjitha këto janë me rrezik. Sipas një studimi të Shoqatës për Studime Politike në

Mbretërinë e Bashkuar, Partia Konservatore do të mbetet më e madhja, por ka skepticizëm ndaj sondazheve që sugjerojnë se ajo do të ketë shumicë të qartë. "Ky parashikim i kujdesshëm për asnjë mazhorancë pasqyron mësimet e marra nga viti 2017, kur parlamenti i varur ka befasuar shumëkë", ka thënë Joe Greenwood, nga Shkolla Ekonomike në Londër. Qytetarët që duan të qëndrojnë në Bashkimin Evropian, janë të ndarë midis disa partive, ndërsa ata pro Brexit-it duket se janë të bashkuar kryesisht pas Konservatorëve.

Ish-kryeministri turk formon parti, sfidon Erdoganin

ANKARA, 12 DHJETOR - Ish-kryeministri turk, Ahmet Davutoglu ka themeluar një parti të re politike të enjten, hap që tregon sfidimin e partisë në pushtet të presidentit, Recep Tayyip Erdogan. Davutoglu ka dërguar edhe zyrtarisht aplikacionin për të formuar partinë "Partia e së

Ardhmes", ka raportuar gazeta, Cumhuriyet. Ai pritet të bëjë publik lajmin për partinë sot (e premte). Kjo është një nga dy partitë që do të krijohen nga ish-aleatët e Erdoganit, në kohën e raportimeve për mospajtime brenda partisë së tij, të cilën Erdogani e drejton me një stil autoritar.

Ali Babacan, ish-zëvendëskryeministër, ministër i Jashtëm dhe ministër i Ekonomisë, ka bërë të ditura planet për krijim të partisë së re. Urgjenca e formimit të partive të reja vjen në kohën kur në Turqi janë rritur zërat për ulje ekonomike dhe shifra të larta të papunësisë. Partia e tij për



Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (5)

REZISTENCA E ASHPËR PËR JETË A VDEKJE



LULZIM SAHITI

Kështu nisët rrugëtimi i mundimshëm përpjetë luginës nga kishin ardhur. Forcat kriminale në gjendje gatishmërie prisnin vetëm çastin për ta goditur kolonën çlirimtare. Nuk ka zgatur udhëtimi as dhjetë minuta kur prita e dytë armike pa asnjë paralajmërim gjuan me një plumb drejt kolonës për t'u dhënë sinjal pozicioneve të tjera serbe për fillim të aksionit. Plumbi ngulitet në tokë duke nxjerrë dheun e zi mbi dëborë por, për fat, pa qëlluar askënd nga ushtarët. Ishin vetëm pak sekonda kur fillon sulmi brutal dhe i pandërprerë nga pushkët automatike, mina tromloni, bomba dore dhe me breshëri mitralozash të rëndë. Sulmojnë në mes të kolonës së ushtarëve të UÇK-së, me qëllim për të krijuar konfuzion dhe frikë. Përballë kolonës, menjëherë pason goditja e dytë e pandërprerë nga prita e parë armike duke gjuajtur rrufeshëm nga të gjitha llojet e armatimit që kishin në dispozicion. Pastaj, lufta nisi të zhvillohej nga të tria anët ku ishin pozicionuar paraprakisht forcat kriminale. UÇK-ja filloi të riorganizohet shpejt, duke u mbrojtur në grupe të vogla dhe duke u tërhequr pjesa dërrmuese në drejtim të Shqipërisë, kurse një pjesë pak më e vogël ka çarë rrethimin në drejtim të Kosovës. Një plumb goditi çantën e kuqe të Emrush Behlulit që kishte mbi supë. Fuqia goditëse e plumbit, çantën e ngritë thikë përpjetë, por ushtari në fjalë fatbardhësisht shpëton pa asnjë lëndim. Mandej, pason goditja tjetër e cila fillimisht ka qëlluar në dylbi të snajperit "Sig Sauer" që kishte në dorë Xhevdet Qeriqi. Pas pak çastesh një plumb e godet edhe atë në bërrylin e dorës së majtë. Fuqia e furishme e plumbit e rrotullon ushtarin në fjalë. Në të njëjtën kohë, plagë të rënda merr në krahun e majtë dhe trup Enver Deliu nga Rrezalla, të cilit ndihmën e parë ia jep Xhevdet Topalli duke hyrë nëpër plumba të armikut dhe e bart në shpinë përgjatë vijës së frontit. Madje përmbi shpinë të tij, Enverin e

godet edhe një plumb tjetër në bel. Pastaj e kanë ndihmuar në tërheqje: Vesel Aruqi, Haxhi Kiqina, Isuf Abazi me bashkëlufetarë të tjerë. Luftimet zhvilloheshin fyt për fyt me forcat ushtarake serbe, të cilat kishin përforcime në vazhdimësi nga pozicione të ndryshme, madje edhe me qen të shkathët kufitarë. Në ndërkohë plagoset në shpinë dhe në gjurin e majtë Haki Morina, të cilin e ka ndihmuar për tërheqje Xhemshit Krasniqi me shokë të tjerë të luftës. Zëra e britma dëgjoheshin gjithandej, mirëpo ushtarët çlirimtarë vazhdojnë të çajnë rrethimin me shumë mund e sakrificë duke hapur zjarr vetëm në drejtimin nga vinin krismat e pushkëve. Pra, orientimi i gjuajtjeve është bërë kryesisht duke marrë në shenjë tytat e armëve armike që villnin flakë në drejtim të kolonës së UÇK-së. Mirëpo, duke bërë përpjekje titanike që nga ai rrethim i zjarrit, t'i tërhiqnin shokët, nga plumbat e armikut bien në altar të lirisë: Xhevat Shaban Thaçi (29) nga Llapushniku, Bekim Qamil Bytyqi (20) nga Dejna, Ilir Hazir Asllani (29) nga Makërmali, Muhamet Aziz Dërvishi (31) nga Gradica, Sylejman Zeqir Elashani (41) nga Gllbari, Mevlan Tefik Hoxhaj (24) nga Zhuri, Gani Halit Elshani (43) nga Krajkova, Gani Hasan Zogaj

(25) nga Rigjeva, Agron Mahmut Mehmeti (25) nga Shtrubullova, Maliq Hamëz Karaqica (49) nga Balinca, Isaj Muharrem Morina (40) nga Vrajaka, Ali Halil Krasniqi (23) nga Çabiqi - vëllau i Mujës, Beqir Sefë Gashi (32) nga Mleçani, Hysen Kadri Byjupaj "Luani" (29) nga Istogu - i fejuari i Luljetës, Bashkim Azem Krasniqi (21) nga Zllakuqani, Rifat Fazli Mëziu (30) nga Marina dhe Kadri Jahir Gashi (18) nga Balinca. Flijimi i tyre ishte shembull i përkushtimit për atdhe, liri dhe ardhmëri. Në këtë rrëmujë të paparë, ku vinin plumbat sikur breshër, luftëtari Gazmend Nebihu, pas një rezistence me pushkëmitroloz në dorë, arrin të tërhiqet nga rrethi i zjarrit të armikut dhe fillon t'i shpejtojë hapat nëpër borë për t'i zënë shokët para tij, mirëpo më lart afrohet rastësisht pranë një kukulle mashtruese me veshje ushtarake, e cila fillimisht ka lëshuar një alarm dhe mandej në afërsi të saj ka pasuar një eksplozim. Për fat, Gazmendi shpëton pa therë në këmbë duke u tërhequr shumë shpejt tatëpjetë.

Në këtë betejë trimash, me plagët e pashëruara ende në trup, komandant Mujë Krasniqi "Kapuçi", ngjitet te vija e frontit, ku bashkëbisedon me Naser Lekun, nga i cili njoftohet për luftimet dhe të vrarët në luginë.

Ai, pra Muja, për të shpëtuar sa më shumë jetë të ushtarëve, kishte kërkuar nga Naser Leku, Luljeta Shala, Avni Kutllovci, Agim Mziu, Faton Xhylani dhe Enver Olluri që të tërhiqen nga ky pozicion, ndërsa vetë kishte vazhduar luftimet duke iu kundërpërgjigjur forcave serbe në distancë të afërt. Kjo qëndresë heroike e pashembullt, që e përflaku agimin e Pashtrikut, u ndërpre nga breshëria e një arme armike, e cila goditi rëndë pishtarin e luftës çlirimtare, Mujë Halil Krasniqin (31) nga Çabiqi, komandant i Brigadës 113 të Zonës Operative të Drenicës. Ai ra heroikisht duke mbetur një yll i pashuar i lirisë. Përndryshe, shquhej për guximin, trimërinë e tij në fushat e betejave që zhvilloi UÇK-ja kundër forcave serbe.

Naser Leku nga Baica e Elashanit (Drenas) me grupin e bashkëlufetarëve, përveç Enver Ollurit i cili ishte ndarë nga grupi menjëherë, kishte vazhduar tërheqjen graduale, në të djathtë nëpër malet e Pashtrikut. Kanë ecur të pestët së bashku deri rreth orës 15:00. Pastaj, janë ulur në një livadh me shkurre të vogla për t'i lidhur një plagë të lehtë që kishte marrë Luljeta në orët e hershme të mëngjesit. Ajo kishte plagën afër zogut të këmbës së djathtë, të cilën i ndihmon ta pastrojë dhe fashojë, bashkëlufetari i luftës,

Naseri. Në të djathtë të belit kishte plagën tjetër, ku plumbi e kishte shpuar rripin e uniformës së saj ushtarake. Mirëpo, këtë varrë pushke, Luljeta e lirisë nuk kishte arritur ta pastronte ngaqë papritmas kanë vërejtur forcat tjera të armikut me uniformë të zezë duke ardhur. Në këtë kohë, Naseri ishte duke veshur jelekun. Ai kishte humbur kontrollin dhe nuk kishte lëvizur fare nga vendi, vetëm ishte shtrirë në borë, ndërsa katër të tjerët qenë tërhequr për të nxënë pozicion luftarak. Nuk kishte zgatur shumë e të jenë dëgjuar krismat e armëve vdekjeprurëse, ku luftëtarja që rrezatonte rreze lirie Luljeta Jahir Shala (21) nga Krajkova së bashku me trimat e lirisë: Agim Halil Mëziu (24) nga Marina, Avni Bislim Kutllovci (21) nga Sfarçaku i Epërm dhe Faton Nazif Xhylani (17) nga Baica kanë qëndruar heroikisht deri në fishekun e fundit. Forcat shumëfish më të sofistikuara të armikut sulmojnë mbi luftëtarët e patundur, të cilët e bënin luftën në një pozicion të hapur. Në luftë e sipër mbi ta kanë rënë rafalët e armës kobtare të armikut. Ata ranë dëshmorë për çlirimin e atdheut duke mbetur në përjetësi yje të pashuar. Ndërkohë pushojnë të shtënat dhe Naseri merr veten e nisët i vetmuar në drejtim të panjohur. (Vijon)



Lugina e Pashtrikut me dëshmorët e rënë për lirinë e Kosovës



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

E jashtëzakonshme

Gropa gjigante "gllabëron" makinat

Një gropë gjigante "gllabëroi" makinat në kryeqytetin e Brazilit. Ngjarja ndodhi pranë një zonë ndërtimi pas shembjes së një pjese të rrugës. Të paktën katër makina ranë në gropën e madhe që u hap. Nuk raportohen të lënduar nga ngjarja.



FOTO E DITES



Një fëmijë shihet duke u luhatur në plazhin Lhoknga në provincën Aceh të Indonezisë. /AFP/

E rrallë

Zbulohet fosili i një dinozauri që ka jetuar 70 milionë vjet më parë

Në Argjentinë është zbuluar në një sit arkeologjik fosili i një dinozauri që ka jetuar rreth 70 milionë vjet më parë në zonën jugore të vendit. Paleotologët shprehen se ky është një zbulim domethënës pasi na



një me një specie të rrallë që ka populluar këtë zonë miliona vjet më parë. Specia barngrënëse, e quajtur Nullotitan Glaciaris, ishte e gjatë rreth 25 metra, me katër këmbë dhe kishte qafë të gjatë.

BARSOLETA E DITËS



Shitësi i drejtohet të birit:
 - Pse more bir i ke pirë gjithë këto "Cola Cola"?
 - Kanoçet po shiten shtrenjtë babi. A i ke parë njerëzit qysh po i mbledhin nëpër kontejnerë?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Marrëdhënie e shkëlqyer me partnerin.

Po toleroni ngarkesat e njëri-tjetrit në punë dhe kjo gjë ju ka afruar më tepër.



DEMI
Edhe armiqtë në raste të veçanta kthehen në miq të mirë.

Kjo thënie vlen për ju sot sepse një kundërshtar i betuar do të dalë në anën tuaj.



BINJAKËT
Sot do të jetë një ditë e qetë dhe

aspak stresuese. Çdo gjë po shkon siç e keni programuar dhe do t'ju krijojë mjaft çaste të lira gjatë ditës.



GAFORRJA
Sot do t'ju kujtohen shumë

çaste të këndshme nga fëmijëria që do të doni t'i rijetonit nën një aspekt tjetër.



LUANI
Familja do t'ju falë më tepër

dashuri nga sa duhet. Kjo do të bëjë që të ndiheni shumë të izoluar nga pjesa tjetër e ambientit shoqëror.



VIRGJËRËSHA
Sot po bashkëbisedoni me

njerëz që shumë shpejt do të jenë miqtë tuaj më të mirë. Njohjet e reja ju sjellin shumë surpriza.



PESHORJA
Kujtimet do të jenë kurthi juaj në këtë ditë.

Do të keqinterpretoni disa situata vetëm për shkak të kujtimeve të trishtuara.



AKREPI
Sot do të keni debate të ashpra me

një koleg pune. Nuk do të doni ta lini gjithçka vetëm në këtë zënkë, por do të krijoni situatë stresuese.



SHIGJETARI
Karakterit juaj gazmor dhe plot ngjyra

nuk shkon fare me këtë ditë që paraqitet shumë e qetë. Ndonjëherë edhe pak tonalitet neutral ju bën shumë mirë.



BRICJAPI
Ambicia është pjesë e karakterit

tuaj dhe ju e shfaqni pa shumë problem. Në shumë raste është një gjë mjaft e mirë.



UJORI
Ju pëlqen ambienti në të cilin punoni dhe

pavarësisht stresit, ju e bëni me qejf punën tuaj. Gjithmonë të pavarur në mendime, sot do të shkëlqeni.



PESHQIT
Edhe pse sot do të

keni shumë punë, do të jeni të qetë dhe do të mirorganizoni gjithçka që ju del papritur.

Robert Berisha publikon këngë të re



Këngëtari Robert Berisha ka publikuar këngën e re e cila titullohet "T'kam dasht". Kjo këngë është bashkëpunim me Kley

dhe Fabio. Tekstin e ka shkruar Kley, kurse për miksimin dhe masterizimin është përkujdesur Duobass Records dhe Eno.

A ka lindur Anne Hathaway?



Duket se Anne Hathaway tashmë është nënë e dy fëmijëve. Aktorja dhe bashkëshorti i saj, Adam Shulman, janë parë duke shëtitur në park në Connecticut bashkë me djalin e tyre trevjeçar Jonathan dhe me foshnjën e tyre. Në

fotografitë që janë publikuar nga "Daily Mail", aktorja e veshur me pallto, kapele, çizme dhe dorëza është parë duke ecur përkrah bashkëshortit që po e mbante një karrocë që dukej se ishte për foshnjën të sapolindura.



Cassie Ventura publikon fotografinë e parë të vajzës

Këngëtarja e njohur Cassie Ventura është bërë nënë për herë të parë të martën. 33-vjeçarja ka publikuar fotografinë e vajzës në "Instagram". Ajo mori shumë urime nga të famshmit. Një ndër ta është edhe Kim Kardashian. "Ajo është ndryshe", ka shkruar Ventura.



Brad Pitt hedh poshtë thashethemet për lidhjet: Asgjë nuk është e vërtetë



Për herë të parë Brad Pitti ka folur për jetën e vet private. Në një intervistë për "New York Times Magazine", aktori zbuloi se ndaloi së kushtuari vëmendje shtypit për veten e tij rreth 15 vjet më parë. "Kam ndaluar së lexuari

shtypin që nga viti 2004", ka deklaruar 55-vjeçari. Ylli i Hollywoodit shtoi: "Nuk e di se sa gra kanë thënë që unë jam në një marrëdhënie përgjatë dy ose tre vjetëve të fundit. Por, asnjë prej tyre nuk është e vërtetë", ka thënë Pitti.

LIBËR NGA, MEJDI ASLLANI - KOMANDANTI QË SHPARTALLOI POLICËT SERBË

"ECJE NËPËR KUFOMA", Rrëfime nga komandant, "Plaku i Emshirit", faqe 303. botoi shtëpia botuese, "Newborn Publishing"



SHKRUAN: AFRIM

MUSTAFA,

Ish-reporter dhe veteran i luftërave të UÇK-së

Pas një pune të palodhshme disamujore, shtëpia e botimeve ekskluzive, "Newborn Publishing", kurorëzoi me

sukses botimin e librit të ri dhe shumë të veçantë, me titullin simbolik, "Ecje nëpër kufoma", të autorit, komandantit të mirënjohur të UÇK-së dhe UÇPMB-së, Mejdin Asllani-Komanant, "Plaku i Emshirit"... Ky libër është botim i veçantë, sepse sjell për opinionin gjithëkombëtar rrëfime shumë të veçanta dhe shumë interesante të veprimtarisë atdhetare të gjashtë dekadave të fundit të veprimtarit dhe atdhetarit të mirënjohur gjithëkombëtar, Mejdin Asllani.. Rrëfimet janë interesante, nga faqja në faqe, nga ngjarja në ngjarje, sepse

bacha Mejdin, gjatë gjithë jetës së tij, ishte gjithmonë dinamik, veprues dhe i pandalshëm për të mirat e atdheut. Janë, interesante, rrëfimet e, pothuajse, një jete të tërë të veprimtarit, Mejdin Asllani nga vitet gjashtëdhjetë e këndeje, por edhe më herët... "Plaku i Emshirit", sikur ka dashur që, periudhën e luftërave të UÇK-së, të mos e rrefejë sa duhet, me modestinë se, këto ngjarje po ashtu, tejet interesante do t'i tregojë në botimin e dytë dhe pasues, i cili do të botohet gjatë vitit 2020. Komandant, "Plaku i Emshirit" ishte ai, i cili, në mars të vitit 1999 u ballafaqua drejtpërdrejt me armikun gjakatar serb dhe luftoi drejtpërdrejt me policinë serbe, duke arritur që në vetëmbrojtje e sipër, t'i vrasë si qentë dy policë barbarë. Për shkak të origjinalitetit dhe veçantisë faktike të ngjarjeve të këtij publikimi, është interes publik që i njëjti edhe të përkthehet në anglisht, e në të tjera gjuhë.. Sponsorimin e pjesëshëm të librit, "Ecje nëpër kufoma" të autorit, Mejdin Asllani e bëri bashkatdhetari dhe veprimtari nga struga, në SHBA, njëherit luftëtar i UÇK-së, Fluturim Rizvani. Porosia për librin mund të bëhet në: 044 235 679



Fehmi Shaqiri dekorohet me titullin "Mjeshtër i Merituar"

Me titullin "Mjeshtër i Merituar" është dekoruar sot Fehmi Shaqiri, duke u vlerësuar për kontributin e tij në ruajtjen dhe promovimin e vlerave tona kombëtar, shkruan KultPlus.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi përmes llogarisë së tij

socialë Facebook ka njoftuar për këtë gjë, ku është shprehur se Shaqiri i ka dhënë shumë kulturës sonë.

"Me çmimin "Mjeshtër i Merituar", sot e dekorova Fehmi Shaqirin, i cili me dekada të tëra ka kontribuar në ruajtjen dhe promovimin

e vlerave tona kombëtare. Ai i ka dhënë shumë kulturës sonë në Shqipëri, në Kosovë dhe kudo në diasporën shqiptare. Familja Shaqiri në vazhdimësi ishte e angazhuar për ruajtjen e identitetit tonë kombëtar", ka shkruar Thaçi.



Artistët shqiptarë organizojnë mbrëmje koncertale bamirësie në Teatrin Oda

"Në gjirin tim kam hapur varr, Që t'i jap shpresë - edhe t'ja marr", me këto vargje të Lasgush Poradecit, artistët shqiptarë kanë bërë ftesë për të gjithë adhuruesit e muzikës e poezisë, të marrin pjesë në mbrëmjen koncertale të bamirësisë, shkruan KultPlus. Mbrëmja koncertale e datës 18 dhjetor, do të mbledhë në Teatrin Oda, artdashës të muzikës dhe poezisë për një mbrëmje të veçantë, jo vetëm për nga muzika e interpretuar, përjetimet personale të artistëve, poezitë por edhe për nga qëllimi i aktivitetit të organizuar.

Koncerti i përvitshëm "Udhëtim dimëror" - Jazz dhe Poezi; me muzikantë e aktorë, vendas e të huaj, këtë herë realizohet për të kontribuar drejtpërdrejt në ndihmë të vëllezërve, motrave

dhe familjet e prekura nga tërmetet e fundit në Shqipëri.

Artistët që do të marrin pjesë në këtë mbrëmje janë: Ilir Bajri, Eda Zari, Elina Duni, Visar Kuçi, Armend Xhaferi, Fatlume Bunjaku, Tavitjan Brothers, Gent Rushi dhe Shpat Deda.

Të ardhurat e këtij koncerti do të shkojnë, direkt për familjet e dëmtuara nga tërmeti, atyre me pasoja traumatike, me një bilanc të frikshëm humbjesh gjithëpërfshirëse.

Iniciatorë dhe organizatorë janë artistët dhe Teatri ODA.

Hyrja është 12 Euro. Të gjithë mund të kontribuojnë sipas mundësive në Teatrin ODA, në kutinë e vendosur për këtë qëllim natën e koncertit, e cila do ketë pranë një Formular të Protokolluar, mbajtur me emrat e secilit nga pjesëmarrësit. / KultPlus.com



Tryezë shkencore për Ymer Jakën, u konsiderua model i atdhetarit dhe studiuesit

Xhemile HYSENAJ

Nuk ka shumë ditë që janë bërë plot 10 vite që kur profesori dhe studiuesi i mirënjohur, Ymer Jaka është ndarë nga jeta.

Për të nderuar kujtimin dhe veprën e tij, Dega e Letërsisë në kuadër të Institutit Albanologjik ka organizuar një tryezë shkencore, ku u trajtuan veprimtaria shkencore dhe intelektuale e Ymer Jakës.

Për të nderuar figurën e Jakës, nga Tirana kishte ardhur Tefta Cami, e cila në vitet 76-78' ishte ministre e arsimit dhe kulturës në Shqipëri, duke bërë kështu që të kishte marrëdhënie të mira me të ndjerin Ymer Jakën, dhe jo vetëm, ajo tregoi se ata ishin bashkëpunëtorë në disa projekte që kishin qëllim çështjen kombëtare. "E kam parë e vlerësuar të ndjerin, profesorin Ymer Jaka, të cilin e kam quajtur

mik, vëlla, shok e bashkëluftëtar. Unë kam qenë me fat që si ministre e arsimit dhe e kulturës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të isha pjesë e projektit të madh kombëtar të Shqipërisë, për afrimin e shqiptarëve këtej Drinit, me atdheun amë", shprehej ajo para të pranishmëve.

Ndër të tjerash, ajo tha se Ymer Jakën e konsideronte si model të atdhetarit dhe studiuesit, për të cilin pohonte të kishte pasur një strategji të qartë në punën e tij të cilat ishin në interes të të gjithë shqiptarëve që përfshihen në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, duke përfshirë shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të zi si dhe të Luginës së Preshevës e të Bujanocit.

"Ymer Jaka rrezatonte modelin e atdhetarit dhe të studiuesit skrupuloz që zgjodhi e trajtoi temën kombëtare, këtë e orien-



tonte dhe e kërkonte edhe nga elita shkencore e studiuesve në Kosovë", vazhdoi tutje ajo.

E për të nderuar kujtimin dhe

veprën e Ymer Jakës, i pranishëm ishte edhe ish drejtori i Institutit Albanologjik, Fazli Sylja. Ai tregonte se si bashkë me Jakën kishin punuar në një periudhë mjaft të errët të vendit tonë, duke mos haruar të fliste me adhurimin më të madh për veprimtarinë e tij. "Si gjeneratë na ka takuar që të jetojmë e të veprojmë në kohë mjaft të errëta për kombin tonë, prandaj politika ishte pjesë e pandashme e jetës dhe punës sonë. Edhe në këto rrethana, profesor Jaka, studiuesi dalluar, shquhej për punë të vazhdueshme e shumë të guximshme në reagimet e duhura ndaj çdo situatë apo provokimi që sillte politika e kohës", potencoi ai.

Profesori i nderuar, kishte shumë miq e dashamirë, ndër ta edhe Giuseppe Chiaromonte, i cili nga Palermo kishte dërguar kumtesën që i dedikoi Ymer Jakës, kumtesë

kjo të cilën do ta lexonte drejtori aktual i institutit Albanologjik, Hysen Matoshi.

Ymer Jaka ishte njëri nga intelektualët më të afirmuar shqiptar. Ai ishte profesor dhe studiues i mirënjohur si dhe përkthyes i afirmuar që prezantoi Skënderbeun para audiencës franceze, ai poashtu ishte edhe njëri prej shqipëruessve më të veçantë si dhe njëri prej veprimtarëve më të përkushtuar për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në ish Jugosllavi. Shumë artikuj e studime të Ymer Jakës, i gjejmë të botuara në revista e gazeta brenda dhe jashtë vendit.

Me letërën që kishte ardhur nga Palermo u përmbyllë kjo tryezë shkencore e cila vuri edhe njëherë në pah veprimtarinë shumë të çmuar të profesorit Ymer Jaka. / KultPlus.com



'Zonja halucinante' nga Mimoza Ahmeti

Drita rrokullisej mbi xhamat e veturës, ndërsa ajo, me një ndjenjë padurimi nxitonte atë paradite të gjente dyqanin më të parë të aromave.

Qëndroi. Edhe u çudit me besnikërinë e veturës: qëndroi menjëherë!

Ajo dhimbje koke do t'i merrte jetën, por pak aromë e mirë do t'i bënte mirë gjer atëherë. Qirinj aromatikë e dhimbja do të lehtësohej!

Askush nuk e dinte se sa vuante ajo nga dhimbjet, por do të ishte e kotë të thoshte ndonjë fjalë, pasi e gjitha ishte një gjuhë tjetër...

Qirinj nuk kishte, të paktën jo aromatikë. Shitësja ofroi disa lule të thara dhe ato ishin vishnje.

Gruaja u mahnit nga bukuria e tyre dhe ideja se të gjitha aromat e mira bashkë jepnin ngjyrën vishnje, e tronditi. Ishin lule të futura në mëndafsh rozë dhe tyl të së njëjtës ngjyrë.

Flokët i kishte të drejtë, por ndjeu se iu bënë me onde; rrobat i kishte të thjeshta, por u ndje e veshur në vishnje; buzët e palyera i shihte gjak vishnje.

Në vagulli gjeti derën dhe doli me lulet në dorë, me aromën e pafundme të grykave e luginave të vjeshtës.

Ishte pranverë.

Sa e bukur dukej ajo rrjetë lulesh në veturën e saj! E kuptoi se nuk ishte vetëm dhimbja që e pati shtyrë të nxitonte në kërkim të aromave, por edhe malli i

pafund për dikë që kishte muaj pa parë. I dha veturës si e çmendur nga gëzimi që e takoi, megjithëse... nuk kishte tjetër veçse: një veturë, një grua dhe një qese mëndafshi me lule vishnje – ky ishte takimi.

Gruaja po u merrte erë luleve. Kënaqësia ishte e pafund, pasi nuk po ndahej dot prej tyre. Ishte si një e puthur e rrallë nga ku nuk ke dëshirë të shqitesh.

Nëse dikush do ta shihte ashtu, mund të mallëngjehej, por një sy i stërvitur mashkulli, në ditët tona, do të neveritej. Kish ikur koha e këtyre puthjeve. Një mirësi e tillë të ngjall krupë! Sidomos e rrethuar me flokë të ondeve të mrekullueshme që, në fakt, janë fare të drejtë.

I shoqi e pati cilësuar si një halucinante, femër që vuante nga përfytyrime të pabazuara dhe nuk e fshihte njëfarë neverie për gjendjen e saj të rëndë.

Por edhe ai tjetri, për të cilin ajo përmallej kaq shumë, nuk kishte ndonjë qasje më të mirë.

Ajo sillej në hapësirën midis burrit dhe të dashurit pa pasur as njërin as tjetrin dhe këtë e quante lumturi qyteti.

Gruaja ishte aq e bukur, sa që mosha e saj nuk kishte rëndësi, por bukuria e saj ishte në një gjendje aq të gjorë, sa që do të duhej të ishte njeri i prekur nga jeta që ta quajë të bukur atë grua. Vuajtjet e nervave e kishin sfillitur. Por nuk ishin ato vuajtje të cilat na vijnë sepse vetë i kërkojmë. Dhe as nga ato që



rastësisht na gjejnë.

Nuk kishte asnjë mundësi shpëtimi prej tyre, pasi ato që e drejtonin, ishin vullnet i paparashikueshëm, i futur në trupin e saj, kushedi nga.

E kishte marrë malli të mërzhitej. Por e kishte humbur këtë të drejtë njerëzore, pasi edhe mërzhia më e vogël ndihmonte atakët nervorë. I dukej e mrekullueshme koha kur mund të mërzhitej, kur mund të vuante nga mendime të kundërta dhe dëshira të papërmbushura dhe kur mund t'u jepte ditëve të saj një pamje të zymtë si moti në kohë me re.

Sa i lumtur është dhe nuk e di, mendoj ajo, sa i lumtur është njeriu që mund të mërzhitet. Mërzhitet dhe nuk vdes!

Te dera e klinikës mentale gjeti disa fytyra të murrme. Prisin, të ulura, radhën. Nuk e kuptoi çfarë e pati atë farë tronditjeje mbi shtresën e përhershme të tronditjes! Pacientët dukeshin të rrënuar. Jo aq nga neurozat, sesa nga skamja. I shkoi ndoshta nëpër mend se mund të ishte një nga ata? Sakaq, dalloj në kokën e njerit një lungë të madhe, plot damarë. I luajti këthiza. U nis të dilte, por te dera u shfaq ndihmësmjeku që i tha:

- Urdhëroni, zonjë!
- Kaloi e trembur midis të sëmurëve që nuk reagues.
- Pas tryezës, me një regjistër të madh përpara, i urtë, si një kec i bardhë, qe ulur doktori. Vitet e shumta ua shtonin freskinë ninëzave që emetonin burim.
- Kam ardhur vetëm të pyes... – tha me ndrojtje gruaja.
- Flisni lirshëm. Nuk do të shkru-

aj asgjë, zonjë, – tha ai. – Nuk po ju hap kartelë.

• Vuaj nga kontraksione, ngjethje të trurit...

• Keni provuar qetësues?

• Nuk m'i pranon trupin.

• Do të mësoheni!

• Ka ndonjë mënyrë tjetër? – belbëzoi ajo. – Ka shërim?

• Duhet besim i jashtëzakonshëm, – tha ai, – është thujse e pamundur.

• Ajo doli pa e mbaruar ai fjalën.

• Mendohuni për një kurë, zonjë!

Kur të merrni vendim për ta përballuar, ejani, por nuk lejohet pirja e qetësuesve me hope! Kuptuat!

Gruaja u gjet përsëri në rrugë. Një shtresë e re pikëllimi u shtrua mbi të përhershmen: mosshërim! Ç'ishte kjo jetë e përzier përditë me vdekje? Plani i vështrimit të saj luhatej, perspektiva e pamjes kurbëzohej. Ishte një luftë e pamatë për t'u bashkuar me unin.

I dukej se merrte urdhra nga një drejtim i panjohur. Sjelljet ishin bërë të çuditshme: midis gjendjeve dhe dëshirave nuk kishte më lidhje. Nuk qëndronte dot në një vend...

I vetmi fakt i pandryshueshëm në ndërgjegjen e saj, në atë ndërgjegje aq të ndryshueshme, ishte fiksimi pas një ideje: Kishte rënë në dashuri!

Ishte kapur për vdekje pas kësaj fijeje, si e vetmja që e mbante në frymë. Vdiste e ringjallej çdo çast duke u mbajtur në të, por edhe kjo ide kishte problemet e saj. Bëhej fjalë për një djalosh të paritur që asaj i dukej burrë. Por nuk ishte ky problemi.

Ndërsa ndodhej përballë tij, ajo ndiente se fusha e tërheqjes krijohet pak më anash tij, disa centimetra më tutje, le të themi. Ajo i

ngulte sytë aty, buzëqeshte aty, përgjigjej aty.

Djaloshi herë pas here kthente kryet anash për të parë se çfarë shikonte ajo aty.

Një ditë ajo guxoi dhe i tha se, pak më anash, diku më anash tij, ishte një dritë e mbledhur, e bardhë si qelibar, ndoshta... dashuria!

Por ai u egërsua nga ky pohim:

• E shikon që nuk je reale? – Përsëriti: – Ta kam thënë që nuk je reale!

• Kaq iu kujtua asaj në atë përhumbje dhe hyri sërish në jetë.

• Shpesa e frymës u ringjall. Kërkonte shembuj shërimi e riardhjeje në frymë, në çdo jetë njeriu.

• Të ishte kaq i madh pasioni i të jetuarit, apo e papërbalueshme një vdekje kaq e gjatë?

Kishte qenë një ditë me re të zeza kur kuptoi se do të vdiste. Një morsë e tmerrshme ia shtrëngoi tëmthat deri te nyjat poshtë qafës. Njësoj si dikujt që e kanë abuzuar... Por ngado që kthente kryet, jeta i dukej një abuzim pa fund.

Kishte vite që ndihej e zbratur. Njerëzit nuk e tërhiqnin. E kish mbyllur kapitullin e të dashurit. A nuk kishte dashuruar aq shumë ajo dikur? Por edhe kjo ide nuk e ngacmoi.

Si katandisi kështu? Goxha grua! I vinte zor që rronte. Po kurrë s'e pati menduar vetëvrasjen, madje as tani.

Dhimbjet bënin kërdinë në gjithë trupin. Duhej një fuqi e mbinatyrshe për të mbetur të gjallë. Ajo s'ishte veçse një mëdyshje fizike. / Exlibris.al

(Pjesë nga romani "Zonja halucinante")



Kur Milto S. Gurra takoi Maksim Gorkin

NGA HYJNI CEKA



Në manastir të “Shën Prodhromit”, në Voskopojë, shoh Milto Sotir Gurrën, shkrimtarin. Të fundmin që trashëguam nga Rilindja jonë. Dukej që larg, tek zbriste për teposhtë... Varej në Përrua të Shpëskës e veç kur ngjitej pastaj, si djalë... Vinte, na gjente, te Zhombri, mbi Çesme.

Bënte kohë që i pati shkuar të tetëdhjetat, po mendjen e kishte qiçer.

Më kujtoi në çast... Për fytyrë jo... Por sa më dëgjoji emrin... Më pati bashkëpunëtor njëherazi te “Mituria” e dyzetekatrës...

– Po mirë, – tha, – sa vjeç ishe atëherë?

– Gjykomë! – e nxita. – Ç’moshë kam tani... Bëj llogarinë!

– Njëzet e tetë, – ia priti në çast...

Po kuptoi që lajthiti.

– Dale, mor i uruar! – e ndreqi. – Pse tetë vjeç paske zënë të shkruash?!

– Sot jam tridhjetë e dy, zoti Milto.

– Vërtet! Vërtet! – u kujtua, më në fund. – Ja delta e Nilit... Në Odesë, kur isha, një çiftut thoshte se, po u shfaq ajo “delta” në cep të syrit, njeriu i ka shkuar të tridhjetat... Ajo rrëfen për moshën e burrërisë.

Fjalë e Milto kishte ngrohtësi dhe ëmbëlsi që sot zor se e gjen gjëkund... rilindës e shkuar rilindësve. Rrëfimin tërheqës e pati shprehur daç në biseda të shtruar, por edhe në libra. Janë ato “Plagët e Kurbetit”, njëherë! Por edhe “Goca e Kaçanikut”, nuk të ka shoqen!

Bënte nga bënte, mendja i shkonte ndër vite të largëta... Tek adoleshenca, te rinia. Kaluar në Odesë e në brigjet e Detit të Zi... Zinte në gojë rusët e Krimesë... Për ta fliste mirë.

– S’e njihnin meskinitetin, – thoshte, – as smirë që kishin. Dy rrugë plot me “dyqane shqiptarësh: “Bollshaja Arnautka” dhe “Malaja.” S’na ngitnin. Çifutët nuk i donin, as turqit. Për çudi, me shqiptarë shkonin!

Aty jam habitur, tek dëgjoja nga goja e tij se tregimet më të para Miltoja i kishte shkruar në

rusisht, botuar ndër revista të Moskës e Petërburgut.

Ishte njohur edhe me Gorkin dhe kishte pasur shkuarje të madhe me të.

Këtë, nuk desha ta besoj njëherë...

Por më bindi... së fundi...

Ato kohëra, kur gjendej në Odesë, pati shkruar një pamflet e godiste Italinë, me ku të dhemb e ku të djeg... E mbyll në pliko dhe ia dërgon, në konfidencë Aleksei Maksimoviçit në Moskë... Seç nxirrte edhe ai një revistë letraro-politike.

Prit se po ia botonin pamfletin. Hiç! Prit... e hiç!

Së fundi, niset me tren. I shkonte Aleksei Maksimoviçit drejt e në Moskë, në zyrë brenda!

Përfytyrojani Milton, me ato vetulla të trasha, të kreshpëruara... Ato buzë të mëdha oparaku, mbledhur e tendosur. Mefistofel i Gëtes!

Po, siç tregonte edhe vetë, Gorki s’ia kishte varur... Kishte

pasur të bënte me shqiptarë dhe më përpara?! Nuk dihet!

Miltoja i qe përgjigjur shtruar:

– Miltiadi Sotiriev! – kish thënë. – Italinë e kam Atdheun tim të dytë. Kam shkruar për të kaq e aq tregime... Për inatin tënd, or vëlla, s’e hedh dot në erë, gjithë veprën time!

Miltoja ishte bërë një dorë aty... Jo se ishte frikësuar gjë, por i ishin derdhur një barrë mendime përnjëherësh...

“S’u prishka bota mes vetes, për hatrin e të voglit”.

Fjalët e fundit i vinin kiamet të rënda! I gjëmonin. I bubulonin. Ia kishte dhënë koka pastaj...

Për inatin tënd, or vëlla, s’e hedh dot në erë gjithë veprën time.

Ç’ndodhi kështu?

Vetëm ne shqiptarët vajtkemi qorrazi pas të tjerëve. Ndryshe bota... Bota llogarit çdo gjë!

Me të gjitha këto, Milto Sotir Gurrës, s’i kishte ngelur qejfi.

Përkundrazi! E ngrinte e vinte në intimitet. Po Aleksei Maksimoviç! Asnjëherë në emër letrar.

Kur do të bënte përmbledhjen e gjithë tregimit, s’iu ndenj pa rrëfyer për Gorkin se, mbas gjithë asaj bisede, kishte hapur sirtarin pastaj, i kishte dorëzuar dorëshkrimin, të ruajtur me kujdes, për aq kohë, nëpër dosje... Dhe e kishte zënë për krahu e kishte futur në shoqëri me artistë e me shkrimtarë. E kishte njohur dhe me Shaliapinin e famshëm në atë rast... E kishin pirë vodka... E kishin bërë romuze. Kështu rrëfente Miltoja për vitet e rinisë së tij. Dhe i largohej të zbehtit e fytyrës. Faqja i skuqej atëherë dhe i zhdukeshin rrudhat e pleqërisë, që të tëra.

Ne shastisnim. S’dinim ku ta mbanim më parë mendjen... te kultura e tij prej enciklopedisti apo te fjala poetike! Gjithsesi, e përcillnim me ndere, kur afronte dreka... E vinim në mes dhe e nisnim. Ai shëmbëllente me Sokratin e lashtë. Dhe... ec e ndalo. Si në bisedat sokratike... më!
/Exlibris.al

Përvjetori i Normales së Elbasanit, shkolla që u hap 110 vjet më parë

110 vjet më parë, në dhjetor të vitit 1909 me vendim të Kongresit të Elbasanit do të krijohet normalja e parë e Elbasanit, si i parë institucion në vend që do të përgatiste mësues e do të përhapte gjuhën shqipe në të gjitha trojet shqipfolëse. Të shumta kanë qenë

aktivitetet me rastin e kësaj datë të shënuar, jo vetëm për Elbasanin. Normalistët e ftuar ndanë mes tyre kujtimet dhe traditat e një arsimit dhe kulture që do të jetojnë gjatë në këtë qytet. Mësuesit e parë të normales do të pushtonin të gjitha trojet shqiptare, që nga zonat e

thella malore, Kosova, Çamëria apo në çdo cep ku duhej përhapur gjuha amtare, pa të cilën një komb është i destinuar të zhduket. Normalja e Elbasanit mban titullin e lartë “Nderi i Kombit” akorduar nga Presidenti i Republikës.
/KultPlus.com



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Distria s'njeh kundërshtar në Kinë, rrëmbeu medaljen e artë

Distria Krasniqi e rrëmbeu medaljen e artë në Mastersin e xhudos, në Qingdao të Kinës, pasi e mposhti mongolezen Narantsetseg Ganbaatar. Trajneri Driton Kuka dhe kryeministri në largim Ramush Haradinaj e kanë vlerësuar lart suksesin e Krasniqit, duke thënë se ajo me suksesin e arritur i ka bërë edhe një herë krenarë të gjithë shqiptarët anembanë botës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Sportistët e xhudos, në krye me trajnerin Driton Kuka, vazhdojnë t'i bëjnë krenarë shqiptarët anembanë botës me sukseset që po arrijnë në garat ndërkombëtare. Xhudistja Distria Krasniqi ka shkëlqyer të enjten në Mastersin e xhudos, në Qingdao të Kinës, pasi e ka fituar medaljen e artë. Distria me ippon në shënim të artë e mposhti mongolezen Narantsetseg Ganbaatar, për ta fituar medaljen e artën në kategorinë -48 kilogramë, ku pjesëmarrës ishin 32 garuesit më të mirë të kësaj kategorie nga e gjithë bota. Në fakt, Krasniqi arriti katër fitore. Ajo rrethin e parë e kaloi pa luftë, më pas mposhti Katharina Menz të Gjermanisë, ndërsa në çerekfinale mundi Orgintsetseg Galbadrakh të Kazakistanit. Në gjysmëfinale kaloi pengesën Urantsetseg Munkhbat të Mongolisë. Ky triumf i solli Distrias 1800 pikë për normën Olimpikë "Tokio 2020". Pas këtij suksesi, trajneri Driton Kuka e ka lavdëruar sportisten Krasniqi. "Pak vëmendje ju lutem. Kosova gjithandë në Kinë. Urime e arta, Distria! Dhuratën më të bukur të ditëlindjes ia dhurove vetes me djersë e mund por, jo vetëm. Shqiptarët në mbarë botën, krenarë me ty! Trajneri në veçanti", ka shkruar Kuka në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa

i menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i kryeministrit në largim të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se xhudistja Distria Krasniqi i bëri të gjithë shqiptarët krenarë me suksesin e arritur në Kinë. "E shkëlqyeshme, e mrekullueshme dhe e artë, kjo është xhudistja jonë, Distria Krasniqi, e cila na bëri krenarë me fitoren e medaljes së artë në Mastersin e xhudos, në Qingdao të Kinës. Çdo fitore e sportistëve tanë është fitore dhe lartësim i imazhit të Kosovës nëpër botë. Ju jemi borxhli për secilin sukses që na jepni emocion të veçantë. Faleminderit!", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Të enjten garoi edhe Nora Gjakova në kategorinë



deri në 57 kilogramë, por kampionia, njëherësh nënkampioni e Evropës, u ndal në luftën e parë nga Jisu Kim e Koresë së Jugut. Sot (e premte) garon edhe xhudisti Akil Gjakova në kategorinë -73 kilogramë.

SHKURT

Tri klube në ndjekje të Kastriot Rexhës

Tri klube të IPKO Superligës së Kosovës në futboll janë në ndjekje të sulmuesit Kastriot Rexha. Gazeta mëson se Drita, Ballkani dhe Llapi kanë shfaqur interesim për sulmuesin shtatlartë. Rexha dhe disa lojtarë të tjerë janë liruar nga skuadra aktuale, Feronikeli. Sulmuesi ende nuk ka folur për të ardhmen, por besohet se ai nuk do të djersitë fanellën e "Niklit" në pranverë.

Neziri konfirmon largimin nga Dukagjini

Portieri Flamur Neziri përfundimisht është larguar nga skuadra e Dukagjinit të Klinës. Lajmin e ka konfirmuar vetë portieri Neziri nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Falënderoj Klubin e Dukagjinit për bashkëpunimin. Falënderoj kryesinë, trajnerët, futbollistët, ekonomët dhe tifozët 'Hithat'. Nga janari nuk jam pjesë e KF Dukagjini. Qytetit të Klinës dhe klubit i dëshiroj suksese në vazhdim!", ka shkruar Neziri.

Interi nis bisedimet me Veronën për Rrahmanin

Lideri aktual në Serinë A, Interi, është duke menduar për transferime në muajin janar. Sipas asaj që shkruan Gianluca di Marzio, drejtuesit zikaltër janë takuar me ata të Veronas për të biseduar për dy futbollistë: mesfushori afrikan Amrabat, i cili është marrë me të drejtë blerje nga Verona te Club Brugge për 3,5 milionë euro. Vlera e tij, me sezonin që po bën, ka shkruar 15 milionë euro. Emri tjetër është mbrojtësi i Kosovës, Amir Rrahmani, që intrigon shumë pasi i ngjan Skrinjar në vitin e tij të parë në Serinë A, kur erdhi me Sampdoria. Ende nuk ka një shifër apo vlerë të Rrahmanit por, sipas asaj që është mësuar paraprakisht, vlera e mbrojtësit prek thuhet 8-10 milionë eurot për Veronën.

Përballje interesante në çerekfinale të Kupës

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Është hedhur shorti për çerekfinalet e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Shorti ka sjellë përballje interesante, ku spikat përballja

në mes të Drenicës dhe Gjilanit. Kampioni vjeshitor, Ballkani, ka punë me Dukagjinin e Klinës, kurse fituesi i Kupës në edicionin e kaluar, Feronikeli, do të

luajë ndaj skuadrës nga Liga e Parë, Lirisë. Interesante do të jetë edhe përballja në mes të Prishtinës dhe Vushtrrisë. Ndeshtjet e këtij rrethi do të

zhvillohen më 8 dhe 9 shkurt të vitit të ardhshëm. Çiftet e çerekfinaleve: Drenica-Gjilani, Dukagjini-Ballkani, Liria-Feronikeli, Prishtina-Vushtrria.



Federeri: Në 2020-n dua fitore të reja

CYRIL, 12 DHJETOR - Roger Federeri nuk e ka shumë mendjen tek e shkuara dhe për të nuk ka shumë rëndësi nëse e konsiderojnë "më i madhi i të gjitha kohëve". Tenisti 38-vjeçar mendon për të ardhmen.

Pavarësisht moshës, ai synon të fitojë sërish. "Objektivi im nuk është ai që të kujtohem si tenisti që i theu të gjitha rekordet. Këtë gjë e kam bërë një herë dhe në disa raste ka qenë fantastike. Nuk jetoj më me të

shkuarën, por dua të sfidoj të ardhmen", ka thënë Federeri. "Unë jam krenar për ato që kam arritur, por nuk është në tipin tim t'i bëj këto gjëra, pasi kam të tjera objektiva për të ardhmen. Unë ndihem me fat për karri-

erën time dhe punoj fort gjithnjë për të qenë në formë ndaj më të mirëve. Dua që në 2020-n të fitoj sërish. Ideja që përballem me gjeneratat e reja më motivon më shumë", ka përfunduar Federeri.



Sejdini: Ne dhe Kosova do t'ia shtrijmë dorën njëri-tjetrit për finalen

SHKUP, 12 DHJETOR - Ndeshja gjysmëfinale e Ligës së Kombeve, sipas të gjitha gjasave, do të luhet në stadiumin "Todor Proeski" në Shkup. Në një intervistë për Lajm TV, kryetari i Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut (FFMV), Muamed Sejdini, ka deklaruar se kjo ndeshje mund të zhvendoset në një stadium tjetër vetëm nëse UEFA e vlerëson si sfidë me rrezik të lartë. "Ne si federatë, por edhe ju si gazetarë, duhet të punojmë që kjo ndeshje të dalë dhe të jetë një ndeshje ku mbi-zotëron futbollit. Do të bëjmë spektakël futbollit, të punojmë dhe të tregojmë dinjitet futbollit dhe t'ia shtrijmë dorën njëri-tjetrit për finalen, qoftë ne apo Kosova. Ne si federatë gjithçka do ta kemi në nivelin më të lartë", ka thënë Sejdini. "Më 18 dhjetor 2019 do të kemi Këshillin Drejtues dhe do të vendosim përfundimisht ku do të luhet. Alternativa e parë është stadiumi në Shkup, por do ta lë një rez-



ervë të vogël nëse Komisioni për Integritet në UEFA e sheh si ndeshje me rrezikshmëri këtë ndeshje, atëherë do të ketë ndryshime. Megjithatë, them se ndeshja do të luhet në Toshe Proeski në Shkup dhe do t'i tregojmë botës se dimë të organizojmë ndeshje të tilla", ka shtuar ai. Ai foli edhe për biletat shtesë që Agim Ademi ka thënë se do të kërkojë nga Federata e

Maqedonisë, duke thënë se është i gatshëm ta plotësojë këtë kërkesë. "Jam mik i mirë me Agim Ademin, por edhe me Dukën, shpesh udhëtojmë bashkë. Nuk i lë anash edhe federatat e Ballkanit. Jemi gjithnjë bashkë. Jam i gatshëm t'ia përbush kërkesën Ademit", ka deklaruar Sejdini. Të dy krerët e futbollit kanë marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi.

Leonard shkëlqen ndaj Torontos, Lakersat mposhtin Orlandon

TORONTO, 12 DHJETOR - Clippersat fituan me rezultat 112-92 ndaj Torontos në fushën e kësaj të fundit, ndeshje ku Leonardo rikthehej për herë të parë në Kanada, skuadër me të cilën u shpall kampion sezonin e fundit. Ylli i clippersave mori fillimisht unazën e kampionit para fillimit të ndeshjes dhe më pas realizoi 23 pikë në parket, duke qenë më i miri për ekipin e tij. Fiton edhe skuadra e lakersave ndaj Orlandos (96-87), takim ku shkëlqeu LeBron James, që realizoi një "triple double" (25 pikë, 11 rebounde e 10 asistime). Sacramento triumfoi 94-93 ndaj



Oklahomës në sekondat e fundit, me Hiieldin që realizoi 23 pikë, ndërsa New Yorku e mposhti me rezultat 124-122 Golden Staten pas kohës shtesë, takim ku u dallua Morris, autor i 36 pikëve. Fiton edhe ekipi i

Milwaukeees me rezultat 127-112 ndaj New Orleansit, ndeshje ku u dallua Bledsoe, autor i 29 pikëve. Në këtë ndeshje MVP i sezonit të fundit, Antetokounmpo, ishte pushim, por mungesa e tij nuk u ndie.

SHKURT

Ronaldo: Do ta dëshiroja finalen Juve - Real

Juventus mund të takohet në 1/8 e finales në Ligën e Kampionëve kundër Real Madridit. Ylli i "Zonjës së Vjetër", Cristiano Ronaldo, ka thënë se do të dëshiroje që me ish-skuadrën e tij të takohet në finale të garës më të fortë në botë. "Real Madridi është një ekip i jashtëzakonshëm. Por, nëse po më pyesni mua, unë do të preferoja të takohesha me të në një fazë të mëvonshme. Nëse do të ofroni t'i takojmë ata në finale, do të nënshkruaja menjëherë", ka thënë Ronaldo.

Messi: Pres një Real shumë të fortë

Ylli argjentinas Lionel Messi ka thënë se Real Madridi është një ekip shumë i fortë, sidomos kur luan në "El Clasico". "E pres një Real Madrid shumë të fortë. Reali është shumë i mirë në ndeshje të tilla. Këto janë ndeshje të veçanta, pavarësisht se në çfarë forme vjen njëri apo tjetri ekip", ka thënë Messi. "El Clasico" në mes të Barcelonës dhe Realit zhvillohet më 18 dhjetor nga ora 20:00.

Zidane: Mund ta eliminojmë Liverpoolin

Zinedine Zidane me shaka ka thënë se Real Madridi do ta eliminonte Liverpoolin në rast përballje në 1/8 e finales së Ligës së Kampionëve. Reali ka përfunduar në vendin e dytë në Grupin A dhe një nga kundërshtarët e mundshëm në fazën tjetër është Liverpooli. "Nëse luajmë kundër Liverpoolit ne do ta eliminojmë atë. Ne nuk mund të bëjmë më shumë rreth shortit", ka thënë Zidane.

Sarri: City, favorit në Ligën e Kampionëve


Trajneri i Juventusit, Maurizio Sarri, e parashikon Manchester Cityn si skuadër favorite për ta fituar Ligën e Kampionëve. Ai ka bërë me dije nuk dëshiron që në 1/8 e finales të përballlet me Real Madridin. "Në 1/8-at është kualifikuar ajka e Evropës, por ka skuadra të nënvlerësuara sivjet, shumë të rrezikshme si Reali i Madridit, për shembull, që dua ta shmang. Ndërsa për favoritin, duke parë situatën e tij në kampionat, besoj se është Manchester Siti i Guardiols", ka thënë Sarri.

Veteli nga Ferrari mund të kalojë në McLaren

Kontrata e Sebastian Vettelit me Ferrarin është e vlefshme edhe për një vit, pra skadon në fund të vitit 2020, por gjermani nuk e ka të qartë se në Maranello do t'ia ofrojnë rinovimin. Paraqitja e tij jo fort bindëse në tri sezonet e fundit dhe shpërthimi i Charles Leclerc duket se kanë ndikuar në mendimin që kanë drejtuesit e "Kokëkuqes" për të ardhmen. Lajmet e publikuara në shtypin francez në lidhje me kontaktet e Lewis Hamiltonit (nuk mohohen askund) me presidentin e Ferrarit dhe të grupit FIAT, John Elkan, nuk sugjerojnë se e ardhmja e Seb mund të jetë sërish në Maranello. Për këtë arsye ai ka nisur të mendojë për opsione të tjera, ku do të ndihej më i sigurt. Siç ka mësuar "Marca", Veteli ka nisur kontaktet me Andreas Seidl, drejtorin sportiv të McLaren F1, për të qenë pilot i kësaj skuadre nga viti 2021, duke marrë parasysh faktin që McLareni është një nga makinat në rritje dhe se brenda dy vjetëve do të ketë motorë Mercedes. Merkatoja e vitit 2021 në Formula 1 duket se do të ofrojë lëvizje të rëndësishme, që mund ta prekin edhe Max Verstappen, përveç Hamiltonin.

REZULTATET

Cleveland - Houston	110-116
Indiana - Boston	122-117
Orlando - Lakers	87-96
Toronto - Clippers	92-112
Brooklyn - Charlotte	108-113
Chicago - Atlanta	136-102
Minnesota - Utah Jazz	116-127
Phoenix - Memphis	108-115
Milwaukee - New Orleans	127-112
Sacramento - Oklahoma	94-93
Golden State - New York	122-124

Autor: GAZMEND MORINA	FUTBOLLISTI NË FOTO	SJELLJA E NJERËZISHME	GLLABËRUES, MAKUT, I PANGOPUR, GRYKË	ORTHOPEDIC FOUNDATION ANIMALS	ISH FUTBOLLISTI ITALIAN KRISTIANO (SAMPDORIA, ATALANTA)	I FILLUAR	DY ZANORE																							
VARG TINGUJSH TË LIDHUR E HARMONIK (shq.)																														
TËRËSIA E GJALLESAVE NË TOKË																														
SHTET NË AFRIKË																														TITULL PËR OFICERË NË USHTRINË E VJETËR TURKE
UJKU (krah.)																														HEROI BOLETINI DIJETARI FETAR MYSLIMAN
TATUAZH (bised.)																				UGANDA, GANA GJERMANI I VJETËR										
OLIVER TUIST																				DY BASHKË- TINGËLLORE										
KORJIE: VEND ME DRURË E ME SHKURRE TË DENDURA																				RADIUM, AZOT										
ZANORE																				SHTERPËSI INDIUM										
I LARMË																				BANJË ALLATURKA BASHKËT.										
ISH FUTBOLLISTI I MANCHESTER UNITED GIGS (shqip.) KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT																				ZOG ROSE, BIBË (sh.shq.) RENOVIM										
DREJTUES I NJË FAKULTETI																				MILLENNIUM INITIATIVE LEADERSHIP RRIPI I LLAMBËS										
RAFINERIA E KROACISË																				HUMANISTI BARLETI (shq.)										
ISH FUTBOLLISTI FATMIR																				BASHKËT. QËLLOJ RASTËSISHT NË NJË NDODHI										
AGIM TEJECI																				ZYRTARIZIM I NJË MARR- ËVESHJE KALORËS MESJETAR										
NANCY																				TEDI ALVES BASHKËT.										
NJË PLANET (pashq.) KRYEQYTETI I FILIPINEVE																				I NDESHA (bised.) NISESHTE										
AKTORI HOLLIVUDIAN ... GIBSON																				MËSYMJE E ZË ME DORË										
NËPËR ARA, ARAVE																				MËSIM PRAKTIK OSE TEORIK (sh.shq.) TREVISO										
SHENJË QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR (sh.shq.)																				KILOGRAM (krah.) KËNGËTARJA CAKULI										
"INDIANA"																				AKTORI SHEHU FUTBOLLISTI TIAGO (PSG)										
PIJE FRESKUESE E ATHËT																				REVISTË QË BOTOHET NË SHQIPËRI NJË LLOJ INSEKTI I MËRZITSHËM										
PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE (Nofka)																				AKTORI MUÇAJ KËNGËTARJA TARNER										
																				NDJENJË E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË POLITIKANI NDOKA										
																				KËNGËTARI RAMAZZOTTI (shq.) RESEARCH KNOWLEDGE EXCHANGE										
																				ZAMBIA, ANGOLA NOTË MUZIKORE										
																				REGJISORI MINAROLLI DY BASHKË- TINGËLLORE										
																				OSAKA ROBERT REDFORD										
																				DY BASHKË- TINGËLLORE SHKRONJA XV										
																				KRIMB I DRURI										
																				UDHËHEQËS I NJË PARTIE POLITIKE										

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Guri Group" Sh.p.k Vrellë, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e inerteve në Lubozhdë komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.01.2019 në ora 10:30 në hapësirat e restorant "Morea" komuna e Istogut do të organizohet debat publik nga kompania "Guri Group" Sh.p.k Vrellë, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e inerteve në Lubozhdë komuna e Istogut.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **"ETG TOBACCO"** shpk me seli në **Prizren**, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit: **810973546** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka **"ETG TOBACCO"** L.L.C u **Prizren**, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: **810973546** i ujedno imenovao Likfidatora o sprovedjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **"ETG TOBACCO"** L.L.C in **Prizren** has come to the decision to quit its business with registry **810973546**. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage- mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bashkim Bardiqi, shpall të pavlefshme Diplomën e SHMT. (tek. makin) "Anton Çetta" Skenderaj

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net